# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXVI - Nr. 7765 E enjte 17 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)




Opinioni i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

## Masakra e gjasave për integrim



Ekemi filluar këtë vit vendimtar për përparimin tonë në familjen e madhe evropiane në mënyrën më të keqe të mundshme. Kostoja e mospasjes së ...

Vijon në faqen 20

Dje në "Deutsche Welle"

Nga CHRISTOPH HASSELBACH

## Kundër BE-së, pro kombit - Populizmi në rritje



AfD i jep një afat përmirësimi BE-së. Sipas kësaj partie, BE duhet të dorëzojë një pjesë të madhe të kompetencave tek vendet anëtare. Nëse kjo nuk ndodh, AfD ...

Vijon në faqen 21



"Kam kontribuar për LSI në zgjedhje"

## Rrëfimi i 'Eskobarit': Policia nuk m'u afrua asnjëherë, familjarët negociuan dorëzimin

I akuzuari për drogë, Klement Balili: Berishën e takova në shtëpinë time. Si u bëra drejtor

Nga ARTAN HOXHA

I akuzuari për trafik droge, Klement Balili tha dje se gjatë periudhës që ishte në kërkim, policia e Shtetit nuk i ishte afruar asnjëherë arrestimit të tij. Personi më i kërkuar në Shqipëri, i cilësuar si Eskobari i Ballkanit ka folur për gazetarin e Report Tv, Artan Hoxha ...

Në faqet 6-7

PRESIDENTI NUK KA VENDOSUR ENDE TE DEKRETOJE MINISTRIN E RI TE JASHTEM

# MIRATOHET QEVERIA E RE, EDI RAMA "PENG" I METES

Përplasje në Kuvend, opozita kërkon debat, Ruçi refuzon. Taulant Balla: Gent Cakaj do bëhet ministër sa të flasë Kushtetuesja. Të larguarit falenderojnë Ramën



*(Në foto)* Deputeti i PD, Sali Berisha, Kryeministri, Edi Rama, gjatë një sesioni të jashtëzakonshëm parlamentar

Në faqen 3

BASHA-KRYEMADHI

## Mblidhet opozita: Do të udhëheqim protestat popullore kundër qeverisë

Në faqen 4

UDHEZIMI I MINISTRISE

## Testimi i gjuhës së huaj që duhet të kaloni për studimet master

Në faqen 13

ZV/KRYEMINISTRI

## "Çudit" Pacolli: Do flas me Haradinajn që të hiqet taksa 100% ndaj Serbisë

Në faqen 16

PROTESTA

## Studentët: Na kanë kërcënuar në shesh, ndaj "u ngujuam" nëpër fakultete

Në faqe10-11

INTERVISTA



## Diana Çuli: Tri gra në kryeministri dhe një komplot i fshehtë ballkanik

Në faqet 18-19

Lista e plotë/ Ja kur duhet të paraqiteni para Komisionit të Aftësisë për Punë

# KEMP-i, 290 emrat që do kryejnë kontrollin mjekësor

*ISSH: Nëse nuk kryeni ekzaminimin, nuk mund të përfitonin pensionin*

NGA VOLTIZA DURO

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka zbardhur emrat e personave që do t'i nënshtrohen kontrolleve mjekësore në KMCAP Epror gjatë muajit janar të këtij viti për të marrë pensionin. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot listën e plotë me




emrat e 289 personave që duhet të kryejnë ekzaminimet brenda muajit pranë Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë. Këta individë, në rastin që nuk do t'i nenshtrohen kontrollit mjekësor, nuk do të mund të marrin apo rimarrin pensionin ...

Në faqet 8-9

MINISTRAT

VOTIMI

## Presidenti flet për paqe, dhe mirëqeverisje: Politikanët janë shërbëtorë

# A do e dekretojë Ramën ministër? Ilir Meta: Kushtetuta e para!

## "Shumica dhe opozita të dialogojnë!"


Tension gjatë një seance parlamentare


Presidenti Ilir Meta

**DIALOGU**

"Mbështes plotësisht mesazhin e Imzot Frendos për rëndësinë e dialogut dhe të bashkëpunimit në interesin më të mirë e kombëtar, jo vetëm midis qeverisë dhe opozitës, por edhe për më shumë dialog kudo, në Kuvend, në shoqëri, në komunitet e në familje. Vetëm kështu do të kemi më shumë paqe dhe begati për të gjithë",- tha z.Meta.

Valentina Madani

Në nisje të sesionit të ri parlamentar, Presidenti Ilir Meta kërkoi dialog mes qeverisë dhe opozitës. Kreu i shtetit nuk hodhi as dje firmën për Edi Ramwn ministër të Punëve të Jashtme. I pyetur nëse do të dekretojë apo jo kryeministrin Edi Rama edhe në postin e ministrit të Jashtëm, z.Meta u përgjigj shkurt 'Kushtetuta është e para'. Në ditën Botërore të Paqes, kreu I shtetit Ilir Meta apeloi për dialog mes shumicës dhe opozitës për progresin e vendit pasi sipas tij vetëm në këtë mënyrë mund të ketë paqe kudo. "Meqenëse jemi në fillim të këtij viti, por edhe të sesionit të ri parlamentar, mbështes plotësisht mesazhin e Imzot Frendos për rëndësinë e dialogut dhe të bashkëpunimit në interesin më të mirë e kombëtar, jo vetëm midis qeverisë dhe opozitës, por edhe për më shumë dialog kudo, në Kuvend, në shoqëri, në komunitet e në familje. Vetëm kështu do të kemi më shumë paqe dhe begati për të gjithë", u shpreh z.Meta. Një mesazh për qeverinë z.Meta dha në konferencën me temë "Politika e mirë në shërbim të paqes". "Kërkojmë me forcë që politika dhe politikanët të jenë në shërbim të qytetarëve, interesave publike dhe familjeve të tyre, t'i shërbejnë mirësisë, paqes dhe zhvillimit dhe jo anasjelltas, duke u kthyer nga 'shërbëtorë', në 'zotër' të jetës, fatit, mirëqenies dhe të ardhmes së qytetarëve", u shpreh kreu i shtetit. Presidenti foli për paqen, shtetin e së drejtës dhe mirëqeverisjen. Në fjalën e tij në "Ditën Botërore të Paqes" një aktivitet i organizuar nga Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Presidenti Meta përsëriti mesazhin e Papës për politikën dhe politikanët. "Paqja fitohet me shumë mund dhe sakrifica, por është po aq e vështirë që ajo të mbrohet nga interesa të ngushta, që nëpërmjet nxitjes së konflikteve sociale, etnike apo fetare shkaktojnë luftëra të përgjakshme për përfitime politike apo financiare marramendëse në kurriz të njerëzve. Një paqe e sigurt, afatgjatë dhe e qëndrueshme për të cilën ka nevojë shoqëria dhe njerëzimi vjen vetëm atëherë kur të drejtat, liritë aspiratat, pritshmëritë dhe nevojat e qytetarëve garantohen dhe promovohen vetëm përmes sundimit të shtetit të së drejtës dhe mirëqeverisjes. Mesazhi i Papës për Ditën Botërore të Paqes, që i dedikohet pikërisht "politikës së mirë dhe politikanëve 'shërbëtorë' të paqes tingëllon shumë aktual e jashtëzakonisht i domosdoshëm, dhe është një thirrje që meriton të dëgjohet me vëmendje të veçantë", tha z.Meta. Sipas tij, "Ky mesazh universal, është një kambanë alarmi për mbarë njerëzimin, ku 'globalizimi ekonomik dhe politik' ende nuk është shoqëruar nga 'globalizimi i paqes', ose nga përpjekje të përbashkëta serioze në mënyrë që paqja të trokasë në zemrat dhe shtëpitë e të gjithë njerëzve në çdo cep të botës". Presidenti përmendi se: "Papa Françesku në mesazhin e tij thotë se: 'Ne e dimë se etja për pushtet me çdo çmim, të çon drejt padrejtësisë dhe abuzimit. Politika është një instrument thelbësor për të ndërtuar institucionet dhe komunitetin njerëzor. Por kur jeta politike nuk shihet si një formë shërbimi ndaj shoqërisë në tërësi, politika mund të kthehet në një mjet shtypjeje, marxhinalizimi, madje edhe shkatërrimi'.

### "Meta të mos vonojë dekretin për Ramën"

## PS: Cakaj, ministër i Jashtëm sapo Kushtetuesja të zgjidhë ngërçin




Mazhoranca i kërkoi dje presidentit të reflektojë në pak orë që i kanë ngelur përpara nisjes së seancës së jashtëzakonshme dhe të firmosë dekretet për emërimin e kryeministrit edhe si ministër i Jashtëm, si dhe atë të shkarkimit të ministrit aktual, Ditmir Bushati. "Besoj që deri në orën 17:00 edhe zoti Meta do t'i ketë dhënë fund një historie të pakuptimtë të krijuar artificialisht". Por përgjigja e kreut të shtetit është e shkurtër: "Kushtetuta e para". Taulant Balla, kreu i grupit parlamentar socialist e akuzoi presidentin se po sillet si kryetar alternativ opozite. "Në një situatë që opozita e ka humbur besimin në kryetarin Lulzim Basha, Presidenti Meta është munduar të bëjë kryetarin alternativ të opozitës". Por presidenti pyetjes për këto deklarata i është përgjigjur po me pyetje: "Kush është ky, kryetari i Këshillit të Sigurimit Kombëtar?". Në nisje të sesionit të ri parlamentar, Meta kërkoi dje dialog mes qeverisë dhe opozitës. Mazhoranca dhe Presidenti janë përfshirë në një konflikt të fortë mes tyre pas mosdekretimit të Genti Cakajt si ministër të Jashtëm.




### Vasili: Qytetarë hapni sytë, kjo qeveri nuk njeh ligj

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili u bëri dje thirrje qytetarëve të hapin sytë, pasi sipas tij kjo qeveri nuk njeh zbatimin e ligjit. Duke iu referuar përgjimeve të publikuar nga "Zëri i Amerikës" për emërime politike në Drejtorinë e Burgjeve, Vasili u shpreh se përgjimet janë provë e pakundërshtueshme e shkeljes së ligjit. "Kjo qeveri gjykon t'i shpallë luftë edhe "Zërit të Amerikës" që ka vënë përballë publikut fakte për emërimet politike në burgje. Përgjimet e publikuara nga VOA janë provë e pakundërshtueshme. Kryeministri Edi Rama mban në zyrë emërimet. Thirrja ime është e përsëritur për një ligj që nuk funksionon dhe është kapur nga kryeministri. U them vetëm kaq: Qytetarë hapni sytë. Kjo qeveri dhe këta ministra nuk njohin ligj. Këta nuk kanë trup edhe para provave që i thonë po vetë",- tha Vasili.



### Ligji i kadastrës, LSI: Po shpërdorohet procesi kushtetues

Zëvendëskryetari i LSI-së, Luan Rama, shprehet se miratimi i "Ligjit për Kadastrën" vjedhurazi është një nga rastet e shumta që kjo maxhorancë vepron në kundërshtim me interesat e qytetarëve dhe të vendit. Sipas tij kthimi i ligjit nga presidenti është një shans që maxhoranca të përmirësohet. "Kur shpërdorohet procesi kushtetues i ligjbërjes… Miratimi i "Ligjit për Kadastrën" vjedhurazi e për të vjedhur është vetëm njëri nga rastet e shumtë të shpërdorimit flagrant e në kundërshtim me interesat e qytetarëve e ato të vendit të procesit kushtetues ligjbërës nga ana e maxhorancës. Ndaj, me të drejtë, Presidenti ia ka kthyer Kuvendit për rishqyrtim, njësoj siç ka bërë me "Ligjin për teatrin", me "Ligjin për noterinë", "Ligjin për tatimin mbi të ardhurat" e të tjerë, me përmbajtje të dukshme e flagrante në kundërshtim me Kushtetutën",- tha z.Rama.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



**KËRKESA**
"Kemi bërë kërkesë që votimi i dekreteve për ndryshimet në qeveri të bëhet me debat. Pasi na mbështet Rregullorja dhe Kushtetuta, prandaj kërkoj të zhvillohet debat për shkarkimin dhe emërimin e ministrave. Për këtë kemi paraqitur dhe listën e deputetëve që do diskutojnë", - tha Spaho.

## Berisha: Rama puçist, e ka kthyer Kuvendin në shpellë të mafies

Ish-kryeministri, Sali Berisha ka akuzuar dje gjatë seancë plenare kryeministrin Edi Rama se nuk lejoi debatin për ministrat e rinj se ka frikë se opozita do i nxirrte të palarat për ndryshimet në qeveri dhe pushtetin e tij. "Kështu votojnë këta që kanë frikë nga fytyrat e droguara, kështu votojnë këta që kanë frikë nga hajnat, dhe ky është turp dhe kjo është një faqe e zezë e jotja, por ti s'ke fytyrë, s'ke nder, je një hiç që vepron në këtë mënyrë. Ke frikë ti puçisti i ndryrë që merr të gjitha pushtet dhe nxjerr opozitën jashtë. E keni kthyer parlamentin në një shpellë të mafies, me një kryemafioz, me një puçist që s'ka asnjë parim tjetër përveç pushtetit të tij të papërmbajtur", - tha Berisha. Më tej ai iu drejtua edhe kryetarit të Kuvendit Gramoz Ruçi, të cilit i bëri të ditur se do mbante përgjegjësi për shkeljen e Rregullores dhe procedurave. "Ti sillesh si ministër i fundit i Sigurimit të Shtetit, vetëm ti mund të bësh një veprim të tillë", - shtoi Berisha.

**VOTAT PËR SECILIN DEKRET**

- Lirimi i Senida Mesit 76 vota pro
- Lirimi i Arben Ahmetajt 77 vota pro
- Lirimi i Damian Gjiknurit 76 vota pro
- Lirimi i Mirela Kumbaros 77 vota pro
- Lirimi i Lindita Nikollës 77 vota pro
- Lirimi i Niko Peleshit 77 vota pro
- Lirimi i Sonila Qatos 77 vota pro
- Emërimi i Erion Braçes 77 vota pro
- Emërimi i Anila Denaj 77 vota pro
- Emërimi i Belinda Ballukut 77 vota pro
- Emërimi i Elva Margaritit 77 vota pro
- Emërimi i Besa Shahinit 77 vota pro
- Emërimi i Eduard Shalsit 77 vota pro
- Emërimi i Bledi Çuçit 77 vota pro
- Emërimi i Elisa Spiropalit 77 vota pro

Mazhoranca refuzoi kërkesën që votimi i dekreteve të shoqërohej me diskutime

# Kuvendi voton ndryshimet në qeveri, opozita kërkon debat

## *Ruçi: Në 37 raste të mëparshme nuk është debatuar*

Gati 3 javë nga shpallja e ndryshimeve në qeveri, mazhoranca ka mundur të finalizojë votimin e shumicës së tyre. Kuvendi ka votuar dje jo pa debat, të gjitha dekretet e nxjerra deri më tani nga Presidenti i Republikës, për lirim dhe emërim ministrash. Përjashtim kanë bërë vetëm dy propozimet e fundit, ato për lirimin nga detyra të Ditmir Bushatit si ministër i Jashtëm dhe emërimi në vend të tij i Edi Ramës, i cili njëkohësisht mban dhe detyrën e kreut të qeverisë. Seanca e djeshme parlamentare është shoqëruar me debate për shkak se opozita ka kërkuar që këto ndryshime të votoheshin me debat.



**VOTIMI**
Mes kontestimeve të deputetëve të opozitës, mazhoranca miratoi një nga një të gjitha dekretet, duke konfirmuar kështu propozimet e kryeministrit për ndryshimet në qeveri. Të gjitha dekretet si ato të lirimeve dhe ato të emërimeve kanë marrë 76 ose 77 vota. Ndërkohë që mazhoranca votonte ish-kryeministri Berisha ka zënë foltoren, duke akuzuar kryeministrin se po tentonte ti mbyllte gojën opozitës.

**SEANCA**

Shumica qeverisëse ka pritur më kot deri dje pasdite që Presidenti i Republikës të dekretonte edhe dy ndryshimet e fundit në qeveri, ndaj në orarin e përcaktuar që më parë, kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi ka hapur sesionin e jashtëzakonshëm duke njohur deputetët edhe me rendin e ditës të përcaktuar që më parë. Pas ka lexuar listën e dekreteve për lirim dhe emërim ministrash, ai ka ftuar Kuvendin në proces votimi. Por më parë i ka dhënë fjalën krerëve të grupeve parlamentare për t'u shprehur mbi procedurën e votimit. Kryetari i grupit parlamentar demokrat, Edmond Spaho ka kërkuar që votimi të bëhet me debat. "Kemi bërë kërkesë që votimi i dekreteve për ndryshimet në qeveri të bëhet me debat. Pasi na mbështet Rregullorja dhe Kushtetuta, prandaj kërkoj të zhvillohet debat për shkarkimin dhe emërimin e ministrave. Për këtë kemi paraqitur dhe listën e deputetëve që do diskutojnë", - tha Spaho. Fill pas tij fjalën e ka marrë edhe kreu i grupit të LSI-së, Petrit Vasili, i cili theksoi se nuk ka asnjë pikë të Rregullores që ndalon diskutimin dhe debatin. Përgjigjen për kërkesat e tyre e dha kreu i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, i cili theksoi se asnjëherë në praktikën e Kuvendit votimi i dekreteve për ndryshime në qeveri nuk është bërë me debat. "Duhet ta themi shumë qartë që kur çohemi këtu në emër të Rregullores duhet të citojmë një nen të Rregullores", tha Balla. Ndërkohë që në emër të grupit parlamentar republikan, Fatmir Mediu i kujtoi Ballës të mazhorancës nenin 48 të Rregullores së Kuvendit, e cila përcakton se "çdo diskutues, me përjashtim të rasteve kur në këtë Rregullore parashikohet ndryshe, ka të drejtë të flasë jo më shumë se 10 minuta. Koha e përcaktuar dyfishohet kur diskutohet programi politik dhe përbërja e Këshillit të Ministrave. Por Ruçi solli në vëmendje se nga gjithë hulumtimi i bërë nga administrata në më shumë se 37 seanca plenare të tilla, në asnjë rast votimi i dekreteve për lirim dhe emërim ministrash nuk ishte bërë me debat. Ndaj në këto kushte ai ka hapur votimin për dekretet.

## Seanca, ministrat e të shkarkuarit bashkë, të rinjtë në lozhë

Pavarësisht debatit që shoqëroi votimin e djeshëm, seanca e djeshme ishte dhe një moment aspak i këndshëm për ministrat e shkarkuar, të cilët iu është dashur të votojnë për largimin e tyre nga kabineti qeveritar, si dhe një moment i lumtur për ministrat e rinj. Gjatë seancës së djeshme të gjithë ministrat e shkarkuar kanë qëndruar thuajse bashkë në fund të sallës, ndërsa kanë votuar ndryshimet në qeveri. Ajo që ra në sy se ende i padekretuar si i liruar nga detyra e ministrit të Jashtëm, edhe Ditmir Bushati nuk ka qëndruar dje në vendin e tij të përhershëm të ministrit, por i është bashkuar grupit të ministrave të shkarkuar në sallë. Ndërkohë që nga ana tjetër të gjithë ministrat e rinj, që nuk kanë mandat deputeti kishin zënë vend në lozhat e Kuvendit. Kështu, ministrja e re e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku ka qëndruar në një lozhë me ministren e Kulturës, Elva Margariti, ndërsa ministrja e re e Arsimit, Besa Shahini ka qëndruar në një lozhë me ministren e re të Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj.





## Ministrat e larguar mesazhe falënderimi për Ramën

Pas miratimit dje nga Kuvendi të dekreteve të presidentit Ilir Meta për shkarkimin nga detyra, disa nga ministrat e larguar kanë përcjellë edhe mesazhet e lamtumirës nga detyra. Kështu, ish- ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri nëpërmjet një video-mesazhi, ndërsa bënte një pasqyrim të punëve të bëra në këto 5 vite ministër, nuk harronte të falënderonte Ramën për besimin dhe mbështetjen e dhënë. "Një falënderim i veçantë për kryeministrin Rama për besimin dhe mbështetjen që më dha mua si ministër, pa të cilin do të ishte e pamundur të çoheshin para këto reforma",-shprehej Gjiknuri në mesazhin e tij. Një mesazh të ngjashëm dje publikuan në faqet e tyre në rrjetet sociale edhe ish-ministrja e Kulturës Lindita Nikolla dhe ministri në ikje i Punëve të Jashtme Dimtir Bushati.

# OPOZITA
## VENDIMI

### Takimi, opozita e bashkuar të shtunën vendos për ditën e fillimit të protestave

# Opozita nis protestat, Basha: Do të udhëheqim revoltën popullore

## "Ramën do e rrëzojmë me çdo kusht"

Valentina Madani

Opozita do të vihet në krye të protestave mbarëpopullore deri në rrëzimin e Edi Ramës nga pushteti. Opozita mori shkas nga mohimi i debatit në seancën e djeshme plenare për dekretet e ndryshimeve në qeveri, për të shpallur nisjen e protestave. Duke e parë këtë veprim si shkelje të rregullores së Kuvendit, kreu demokrat Lulzim Basha mblodhi mbrëmë aleatët në selinë e PD-së nga ku u vendos që ditën e shtunë të vendosin për fillimin e një valë protestash, të cilat nuk do të ndalin deri në rrëzimin e qeverisë. Pas mbledhjes me partitë e opozitës së bashkuar, Basha deklaroi se do të udhëheqin revoltën e qytetarëve kundër Kryeministrit Edi Rama. Këtë të fundit, Basha e akuzoi se po e çon vendin drejt diktaturës. Në takimin e mbrëmshëm morën pjesë: Monika Kryemadhi, Petrit Vasili, Mesila Doda, Edi Paloka, Nard Ndoka, Fatmir Mediu, Dashamir Shehi, ndërkohë që z.Basha garantoi se opozita do bëjë gjithçka për të rrëzuar Edi Ramën që sipas tij, ka ngritur një parlament privat, qeveri private e shtet privat. "Gjatë gjithë kësaj opozitës i është kërkuar të jetë në parlament. Sot (dje) e gjithë Shqipëria dhe e gjithë bota e pa se si në parlament Edi Rama i hoqi opozitës dhe të drejtën më elementare kushtetuese, të drejtën për të folur. Vendi po rrëshket drejt autoritarizmit dhe diktaturës. Edi Rama ka tani një parlament privat për të shkatërruar interesat kombëtare. Ka ndërtuar një qeveri private për të vjedhur qytetarët, ka ndërtuar një shtet privat për të dhunuar qytetarët. Opozita është e vendosur t'i japë fund krizës politike dhe ekonomike ku është vendi. Prandaj, në përgjigje të mijëra mesazheve dhe duke dëgjuar zërin e qytetarëve ne vendosëm të udhëheqim revoltën e qytetarëve me protesta popullore deri në rrëzimin e Edi Ramës. Ky është vendimi i opozitës së bashkuar",-u shpreh Basha. I pyetur nga gazetarët se kur do të nisin protestat, kryedemokrati njoftoi se data do të vendoset në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të PD-së ditën e shtunë më 19 janar. "Ditën e shtunë, Partia Demokratike do të mbledhë Këshillin Kombëtar për të përcaktuar ditën e nisjes së protestave popullore dhe secila prej partive anëtare të koalicionit të opozitës së bashkuar, përfaqësuesit parlamentar të secilave përfaqësuesit e tjerë do të mbledhin forumet e tyre, do të vendosin dhe do të komunikojmë shumë shpejt nisjen e protestave popullore sipas vendimit që kemi marrë. Ne do të bëjmë gjithçka për t'i shërbyer objektivit që shpallëm këtu, largimit një orë e më parë të Edi Ramës", deklaroi kreu i opozitës Lulzim Basha. Gjatë seancën së jashtëzakonshme kryetarët e grupeve parlamentare të PD dhe LSI kërkuan që të merrnin fjalën për debat për dekretet e Presidentit, kërkesë që u hodh poshtë nga kryetari i Kuvendit, çka solli më pas dhe vendimin e opozitës për protesta. "Për herë të parë në 28 vite demokraci opozita kërkon debat parlamentar për të vërtetat pas emërimeve të kukullave. Opozita parashtroi kërkesë, asnjë rregull i procedurës nuk e pengon opozitën të marrë fjalën, por vetëm një kryetar Kuvendi i marrë peng nga një hajdut psiqik. Kemi një qeveri në koma që erdhi në pushtet me votat e krimit. Jemi në një gjendje emergjence, ku për herë të parë që në kohën e Enver Hoxhës kryeministri mban edhe atë të ministrit të Jashtëm",- theksoi kreu i PD-së.


Kreu i PD-së, Lulzim Basha

**VENDIMI**
"Vendi po rrëshket drejt autoritarizmit dhe diktaturës. Edi Rama ka ndërtuar një shtet privat. Opozita është e vendosur t'i japë fund krizës politike, prandaj në përgjigje të interesit të qytetarëve, vendosëm të udhëheqim revoltën e qytetarëve me protesta popullore deri në rrëzimin e Edi Ramës",- tha z.Basha.


Protesta e fundit e opozitës

### "Nuk ndalemi, parlamenti i marrë peng"

## Kryemadhi: S'ka zgjidhje tjetër, opozita në krye të protestave

Për kryetaren e LSI, Monika Kryemadhi zgjidhja e vetme e opozitës është rrëzimi i Edi Ramës dhe që nga nesër e tutje sipas saj, mediat do të kenë lajme pafund. Ajo njoftoi se prej ditës së sotme do të këtë shumë zhvillime nga radhët e opozitës për të larguar nga pushteti kryeministrin Edi Rama. Kjo deklaratë erdhi pas përplasjes që opozita pati me maxhorancën në seancën e jashtëzakonshme në këtë mbledhje të Kuvendit, ku nuk u lejua që të kishte një debat parlamentar lidhur me emrat e ministrave të



rinj, si dhe ata të larguar. Kryemadhi duke mbështetur fjalën e Bashës, i cili tha se do të këtë një mobilizim të opozitës, tha se nuk ka mbetur asnjë zgjidhje tjetër, e ndërsa u uroi punë të mbarë gazetarëve, duke paralajmëruar se "nga nesër do të këtë shumë lajme dhe zhvillime". "Shumë shpejt do të kemi axhendën, Basha e tha shumë mirë, opozita do të bashkohet. Sot kemi një parlament të marrë peng, shumë shpejt do të njiheni me axhendën dhe strukturën, me të gjithë grupet e interesit. S'ka më nevojë për protesta masive, ke mijëra studentë që protestojnë, prindër, minatorë, etj., që janë gati. Deri më sot opozita ka marrë damkën si zjarrfikës, por tashmë nuk ka më, për të fikur zjarrin e protestës, por opozita do të vazhdojë, do të ndjekë dhe do të vihet në krye të gjithë protestave. Nuk ka asnjë zgjidhje tjetër…

## PD nxjerr dokumentin: Miku i Ramës shpalli falimentin që në 2012

PD përmes zëdhënëses Ina Zhupa publikoi dje dy dokumente që sipas saj provojnë se oxhaku në vlerën e 18 milionë eurove që kreu i qeverisë Rama tha se nuk i përkiste atij, por një mikut të tij është gënjeshtër. Sipas saj në librin e tatimeve miku i kryeministrit, Adrian Dule, figuron si një person me zero transaksione financiare. "Historiku tatimor provon se shoqëria "AD" e mikut të kryeministrit, ka shpallur falimentin në vitin 2012, duke patur të deklaruar zero hyrje-dalje ndër vite. Miku i kryeministrit, që mori përsipër pronësinë e oxhakut 18 mijë euro, rezulton se, i regjistruar si person juridik me emrin "Aramika Studio" në vitin 2017, sërish është i deklaruar me zero fitim. Me deklarimet e tij në tatime, miku i kryeministrit nuk justifikon dot as shpenzimet për të paguar qiranë e studios, jo më të këtë aq para sa për të blerë oxhakun e famshëm 18 mijë euro me të cilin u shfaq Edi Rama. Faturat tatimore me zero hyrje-dalje faktojnë gënjeshtrën e Edi Ramës për oxhakun luksoz. Kryeministri jo vetëm gënjen për të fshehur pasurinë e tij, por është e qartë se ka urdhëruar tatimet të qëndrojnë larg studios ku ai ushtron aktivitetin e tij privat. Të dyja janë vepra të rënda penale dhe dënohen me burg",- tha zj.Zhupa.


**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

**PASURIA nr. 1/358, e llojit "Truall dhe Ndërtesë" (godinë banimi dhe shërbime 3 kate e ndodhur në Ish-Fushën e Aviacionit, TIRANË) me sipërfaqe të truallit 273 m2 dhe sipërfaqe ndërtimi prej 200,2 m2, Zona Kadastrale 8220, Vol. 23, Fq. 28, në pronësi të Znj. DENKË SEFERI.**

**ÇMIMI 25.472.989,70 LEKË** . Data e zhvillimit të ankandit do jetë **14.02.2019.**

**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

**Njoftim për shitje me ankand te II**

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dyte të pasurisë të palës debitore Shoqëria "GI P R A" sh.p.k, e përbërë nga :
·"ARE", Nr pasurie 31/33, ne Z K Nr. 2255, volum nr.5, faqe 235, me siperfaqe totale 7033 m2, ne Koxhas, Durres Ankandi i II fillon me çmim fillllestar ne masen 114.532 Euro.
·"ARE", Nr. n pasurie 31/4, ne Z K Nr. 2255, volum nr.1, faqe 212, me siperfaqe totale 12 900 m2, ne Koxhas, Durres. Ankandi i II fillom me cmim fillllestar ne masen 210.073, 92 Euro .
·"ARE", Nr.pasurie 31/3, Z Ke Nr. 2255, volum nr.1, faqe 219, me siperfaqe totale 4 300 m2, ne Koxhas, Durres Ankandi i II fillon me çmimin fillllestar ne masen. 70.024, 64 Euro.
Ankandi do të zhvillohet në datë 4.02.2019 ora 15:00 në selisë Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kontakt tel. 0672082543, ilir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com.

**Njoftim për shitje me ankand te dyte**

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar ne nenin 568, 577, e vijues te K.Pt.C shpall ankandin e dytë për pasurinë e pales debitore Sh "Strati Construcon" sh.p.k . Pasuria përbëhet nga :
·"Are ", Nr. pasurie 172/23 ndodhur ne Draç dhe Durrës , Z.K Nr. 1522, volumi 3, faqe 249, me siperfaqe totale 1.000 m2 , Ankandi fillon me çmim fillestar në masën 2.240.000 lekë
·"Apartament ", Nr pasurie 116/61-1-19 ne Kryemedhenj Kavajë , Z K Nr. 2291, volumi 22, faqe 42, me sipet 33,19 m2, Ankandi filoin me çmim fillestar në masën 1.064.000 lekë
·"Apartament ", Nr pasurie 116/61-1-20 ne Kryemedhenj Kavajë , Z K Nr. 2291, volumi 23, faqe 43, sipe 59,24 m2 dhe Ankandi fillin me çmim fillestar në masën 1.904.000 lekë
Ankandi qendron i hapur 30 dite dhe do të zhvillohet në datë 4.02.2019 në orën 15:00 në Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5 .Tiranë Kontakt tel. 00355 67 20 82 543 e-mailit ilir_dervishaj@yahoo.com e WEB www.powerjustice-al.com.



Kreu i qeverisë i ktheu përgjigje presidentit Meta për cilësimin si arrogant

# Rama: Unë arrogant? Përgjigjet i jap siç i kam, nuk i zbukuroj

## "Nëpërmjet platformës për 10 ditë vjen zgjidhja"

Kryeministri Edi Rama ka vijuar në distancë debatin me Presidentin e Republikës, Ilir Meta. Ky i fundit do të deklaronte pak ditë më parë gjatë interviste për mediat se sjellja arrogante e Ramës kishte sjellë një tensionim të gjithanshëm të situatës në vend. "Arroganca për fat të keq e Kryeministrit është shkaku i kësaj situate të gjithanshme konfliktuale në vend dhe për këtë na mjafton rasti i marrëdhënieve të institucionit të Presidentit me Kryeministrin për të kuptuar më thjeshtë se çfarë ndodh midis Kryeministrit dhe të gjithë institucioneve të tjera apo Kryeministrit dhe opozitës", - do të shprehej Presidenti Meta. Ndërkohë që dje ka ardhur edhe përgjigja e Ramës, i cili duke folur gjatë takimit të përjavshëm për sukseset e platformës së bashkëqeverisjes, theksoi ai nuk ishte arrogant, por se numri i madh i pyetjeve që i vinin nuk e lejonin që të jepte përgjigje më të kontrolluara. "Kur unë them drejtohu tek Platforma, nuk është as për të hedhur topin jashtë fushës, as për t'u përgjigjur në mënyrë arrogante, se ma kanë gjetur këtë tani, që përgjigjesh në mënyrë arrogante, por të gjithëve atyre që thonë këtë, ju them s'ka problem, do të shohim sesa kryeministra më pas do t'u përgjigjen fare. Nga ana tjetër, përgjigjet unë i jap ashtu siç i kam, sepse nuk kam as mundësi t'i zbukuroj se janë me qindra e qindra mesazhe që duan përgjigje", - u shpreh kryeministri Rama duke i kthyer një përgjigje kështu edhe etiketimit që i bëri pak ditë më parë presidenti Meta. Më tej duke iu referuar diskutimit për platformën e qeverisjes Rama se ajo është rruga e duhur dhe më e sigurtë për të zgjidhur një problem që mund të ketë çdo qytetar. "Kur them drejtohuni tek "Shqipëria që duam , nuk është për të përcjellë pa zgjidhje, por për të çuar aty edhe unë, mesazhet ia çoj direkt Platformës", - shtoi kryeministri. Rama bëri të ditur, gjithashtu, se kërkimi i zgjidhjes së problemeve nëpërmjet platformës së bashkëqeverisjes është gjithashtu një mënyrë për të shmangur jo vetëm burokracitë, por edhe korrupsionin. "Realisht Platforma jep mundësinë që pa pasur nevojë të njohësh kënd, pa pasur nevojë të trokasësh lart e poshtë, pa pasur nevojë të presësh dhe të zvarritesh dhe pa pasur nevojën të fusësh dorën në xhep, të marrësh zgjidhje. Por sigurisht duhet provuar platforma. Tre minuta maksimumi dhe 10 ditë është koha e provës, brenda 10 ditësh zakonisht vjen zgjidhja, ose kur ka nevojë për pak më shumë kohë, koordinatorët njoftojnë se duhet pak më shumë kohë", - u shpreh kreu i qeverisë. Ai, gjithashtu, bëri të ditur se platforma do të ofrojë zgjidhje edhe për të gjitha pyetjet që kanë studentët, duke i dedikuar atyre një dritare të veçantë. "Pata një përmbytje të telefonit javën e kaluar nga studentët, por megjithëse e kemi çuar në sekretaritë e studentëve, përsëri ka shumë pyetje. Te Shqipëriaqëduam.al, aty do të shfaqet rubrika 'Jamstudent'. Edhe Ministria e Arsimit do çelë në 'Facebook' një dritare për të gjitha pyetjet që shqetësojnë studentët lidhur me tarifat apo për çdo paqartësi që kanë" - tha Rama.


Kryeministri Edi Rama

## Llatja kandidat për Elbasanin? Balla: Personalitet i rëndësishëm

Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj dhe kryetari i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla prezantuan dje në Elbasan prefektin e ri të këtij qarku, Gledian Llatja. Prezantimi i tij u bë edhe në prani të kryetarit të Bashkisë së Elbasanit, Qazim Sejdini dhe të stafit të prefekturës. Lleshaj dhe Balla nuk i kursyen fjalët e mira për Llatjen, i cili ditët e fundit është përfolur edhe si një kandidaturë e mundshme për kryetar të Bashkisë së Elbasanit. Nisur pikërisht nga këto zëra gazetarët e pyetën Ballën nëse ai do të ishte kandidatura e PS për Bashkinë e Elbasan, pyetje të cilët kreu i grupit socialistë nuk iu shmang, ndërsa konfirmoi se ai do të ishte një nga emrat që do të diskutohej në forume partiake. "Është personalitet i rëndësishëm i Elbasanit, që e ka përfaqësuar qytetin në institucione të rëndësishme. Z. Llatja do ta vazhdojë ta bëjë edhe në pozicionin e prefektit. Jemi në fazën e vlerësimit të kandidaturave , pse jo dhe z. Llatja do të bëhet pjesë e vlerësimit nëse edhe ka dëshirë të marri këtë përgjegjësi", - u shpreh Balla.

## "Punësime partiake te Burgjet", Gjonaj: Deputetët nuk ndikuan



Në një dalje tjetër të posaçme për mediat brenda dy ditësh, ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj ka kërkuar nga 'Zëri i Amerikës' që të verifikojë dosjen e rekrutimeve të punonjësve në burgje, pas publikimit të disa përgjimeve për rekrutime partiake. Gjonaj u shpreh se VOA nuk mori në konsideratë qëndrimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe argumentet, ndërsa si pas saj procesi i emërimeve është i hapur dhe transparent. "U shpreh për prova që gjendeshin në dosjen hetimore, por pa marrë parasysh se ato prova janë thjesht indicie, të cilat do t'i japin mundësinë prokurorisë për të hetuar me ato se çfarë kanë dalë nga përgjimet. Dhe, ashtu siç e shpjegova dhe dje, nuk kanë të bëjnë me procesin e rekrutimit të punonjësve të policisë së burgjeve. Besoj se do të ishte korrekte që 'Zëri i Amerikës' në bazë të këtyre indicieve të kërkonte të verifikonte dosjen e procedurave të testimit të policisë së burgjeve për të parë nëse interesimi legjitim i deputetëve për çështje të caktuara të personelit të burgjeve është përkthyer apo jo, në shkelje të të drejtave të atyre që kanë marrë pjesë në testim dhe që u takonte vendi sipas ligjit dhe meritës së tyre",- tha Gjonaj. Ministrja e Drejtësisë, nënvizoi se interesimi i deputetëve nuk ka asnjë lidhje me procesin apo rezultatet e rekrutimit të punonjësve të policisë së burgjeve, duke shtuar se procedurat janë zbatuar në mënyrën më të përpiktë dhe çdo hap i ndjekur është lehtësisht i verifikueshëm.


### Invitation to Quote (ITQ)

Albania

World Bank Loan/Credit Name: Citizen Centric Service Delivery Project; 8521- AL

“Goods-IT equipment for ADISA (tablets for institutions live citizen mechanism)”

Ref: AL-8521/G/SH/2.02.04

1. The Government of Albania has received a loan from the International Bank for Reconstruction and Development1 towards the cost of Citizen Centric Service Delivery Project and intends to apply part of the funds to cover eligible payments under the Contract for “Tablets for institutions live citizen mechanism”; Ref: AL-8521/G/SH/2.02.04.

The purpose is to purchase 100 tablets that will be installed and mounted on the wall by the economic operator, in the context of receiving citizen feedback for public services provided by public institutions.

2. The Agency for Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA) invites to quote with regard to the items under this Invitation. Price quotations will be evaluated for all the items together and contract will be awarded to the firm offering the lowest evaluated total cost of the items. The prices should be quoted in ALL (Albanian Lek) for the Total Cost which includes all taxes, VAT, customs, duties, inland transportation and insurance, loading and unloading.

3. The full Invitation to quote document including Technical Specification may be found to ADISA website (www.adisa.gov.al) or requested at the emails below by interested suppliers. Quotation may be submitted by official mail, or electronically at the following address:

ADISA

Blvd: Zhan d’Ark,

Ish shtepia e oficerave, Kati V-te

Tirana, Albania

e-mail: roland.larashi@adisa.gov.al;

and also fiorentina.jorgji@adisa.gov.al; informacion@adisa.gov.al

Interested suppliers may obtain further information at the same addresses.

4. The deadline for submission of Quotation is January 31 2019, 12:00 local time.

# I AKUZUARI PER DROGE

## INTERVISTA

Klement Balili: Kam kontribuar për LSI në zgjedhje. Ambasada e SHBA u ndikua nga politika

# "Eskobari": Policia nuk m'u afrua kurrë, familjarët kanë negociuar dorëzimin tim

## "Berishën e kam takuar, ka ardhur në shtëpinë time"



Klement Balili gjatë intervistës me gazetarin Artan Hoxha

Artan Hoxha

*I akuzuari për trafik droge, Klement Balili tha dje se gjatë periudhës që ishte në kërkim, policia e Shtetit nuk i ishte afruar asnjëherë arrestimit të tij. Personi më i kërkuar në Shqipëri, i cilësuar si Eskobari i Ballkanit ka folur për gazetarin e Report Tv, Artan Hoxha vetëm pak orë para arrestimit. Intervista publikohet e plotë në emisionin "Repolitix". Teksa pohon se është i pafajshëm dhe nuk ka asnjë provë që e implikon në trafikun e drogës Balili flet edhe për lidhjet me politikën dhe angazhimin e tij me PD dhe më herët me LSI, parti për të cilën ai thotë se është angazhuar edhe familjarisht. Ai thotë se në vitin 2006 ka pritur në shtëpinë e tij ish-kryeministrin Sali Berisha. Ndërsa në vitin 2013 emërohet drejtor i Transporteve në Sarandë si shpërblim nga LSI për kontributin në fushatën e 2013-ës*



I akuzuari për trafik droge, Klement Balili

**AKUZA NDAJ BALILIT**

Klement Balili u shpall në kërkim në dhjetor 2016 pasi akuzohet për trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Në dosjen greke ndodhen përgjimet ku Balili rezulton me emrin "Kely". Ambasadori i SHBA në Tiranë ka kërkuar vazhdimisht arrestimin e Balilit, në operacionet për kapjen e tij ka qenë e përfshirë edhe DEA.

**Zoti Balili, prej 10 majit të vitit 2016 dhe deri tani që jemi në mesin e janarit të vitit 2019, keni qenë personi më i kërkuar në Republikën e Shqipërisë. Pra, për më shumë se dy vite e gjysmë keni qenë njeriu nr. 1 në listën e të kërkuarve të Shqipërisë. Pse nuk i jeni dorëzuar drejtësisë gjatë kësaj kohe? Për çfarë arsyesh?**

Për arsyet se nuk kisha provat e duhura këtu në Shqipëri, përse më akuzonin dhe çështja në momentin e parë u politizua në të dy ekstremet. U bënë shumë akuza të rënda ndaj meje, u quajta "Eskobar". Dhe normalisht që unë nuk kisha besim.

**Keni qenë ndonjëherë më përpara i ndaluar?**

Po. Jam arrestuar në vitin 2006, kam qëndruar 6 muaj dhe jam lëshuar pa asnjë pyetje dhe pa prova.

**Ju thanë se për çfarë ju kishin arrestuar dhe a ju thanë në fund përse ju liruan?**

Më arrestuan për një sasi droge (hashash), që ishte kapur në Borsh. Më mbajtën 6 muaj dhe më liruan për mungesë provash, që nuk kisha lidhje.

**Ju jeni akuzuar edhe në atë kohë se keni bashkëpunuar me pjesëtarë brenda Policisë së Shtetit, të përfshirë në trafik të lëndëve narkotike.**

Unë nuk kisha lidhje me të gjitha ato akuza që u bënë. Prokuroria nuk gjeti gjë për mua dhe e pushoi çështjen.

**Sigurisht që të jesh i kërkuari nr. 1 në një vend, edhe si Shqipëria, nuk është një gjë e lehtë për t'iu shmangur arrestimit nga policia. Ku keni qëndruar gjatë kësaj kohe?**

Rrotull, në vendet me publik të madh, si në Gjirokastër dhe në qytete të tjera të mëdha.

**Asnjëherë gjatë kësaj kohe nuk jeni larguar nga Shqipëria?**

Jo, jo, asnjëherë.

**Po si është e mundur që policia në asnjë rast nuk ju ka parë?**

Nuk ka koinciduar ndonjëherë përballë meje. Asnjëherë.

**Policia ka deklaruar publikisht se ka bërë një seri operacionesh për arrestimin tuaj.**

Po, i kam dëgjuar.

**Ka qenë ndonjëherë afër bazës ku keni qëndruar ju?**

Fare, asnjëherë.

**Po si është e mundur që gjatë gjithë kësaj kohe, pra ju të keni qëndruar në Shqipëri dhe asnjëherë policia nuk ka qenë e aftë as që t'i afrohet vendit ku ju keni qëndruar?**

Aty ku kam qëndruar unë nuk ka ardhur ndonjëherë policia. Dhe as nuk ka pasur ndonjëherë mundësinë që të afrohej.

**Gjatë kësaj kohe që keni qenë në kërkim sigurisht që është një gjë e vështirë sepse nuk është e lehtë që të lëvizësh, ka shpenzime, ka kosto, ndërkohë ka edhe një merak tjetër sepse dëshiron që të dish se çfarë ndodh me familjen tënde. Si ia keni dalë që t'i shmangeni të gjitha këtyre operacioneve të organizuara nga Policia e Shtetit?**

Policia kërkonte vetëm në shtëpinë time, në fshat. Normale që unë nuk mund të rrija në fshat.

**Gjatë kësaj kohe, keni ardhur ndonjëherë në banesë për t'u interesuar për familjarët tuaj?**

Po, kam ardhur.

**Policia nuk arriti asnjëherë që ta identifikonte këtë?**

Jo, asnjëherë. Kam ardhur dhe kam ikur.

**VETEDOREZIMI**

> "Unë e kam deponuar edhe vetë më përpara që nëse çështja i kalon drejtësisë shqiptare, unë jam i gatshëm që të dorëzohem në çdo moment. Nga ky moment që çështja ime i kalon drejtësisë shqiptare, unë jam i gatshëm që t'i paraqitem drejtësisë".

**Si i keni mbajtur kontaktet me familjarët?**

Me vështirësi.

**Keni ndjerë ndonjëherë rrezik se dikush, njeri i afërt që mund të ketë qëndruar me ju gjatë kësaj kohe, edhe mund t'ju dekonspironte te policia për shkak të shpërblimit prej 100 milionë lekësh, që ka qenë vënë?**

Jo, jo.

**Nga e mësuat lajmin që ishit shpallur "Eskobari i Ballkanit"?**

Nga media. Unë edhe kur e dëgjova në media, bëra një intervistë te puna ime. Atëherë lëvizja i lirshëm, nuk më kërkonte njeri. 6 muajt e parë nuk më ngacmonte njeri.

**Pra, nga maji deri në nëntor ju keni qenë i lirë?**

Po, i lirë.

Keni jetuar normalisht?

Normal, po. Dilja çdo ditë në qytet. Isha pezulluar nga puna dhe isha i lirshëm.

**Nuk ju kontaktoi ndonjë njeri nga policia, për t'ju thënë që jeni person i hetimi në Greqi?**

Jo, as edhe një.

**Ju vetë gjatë kësaj kohe, ndjetë rrezik që mund të arrestoheshit?**

Po, ndieja rrezik por nuk trembesha. Nuk ruhesha që të fshihesha. Pastaj kur u politizua shumë dhe u bë bujë e madhe, normale që kisha frikë dhe atëherë vendosa që të fshihesha.

**Kur vendosët të largoheshit nga banesa dhe t'i fshiheshit arrestimit nga policia?**

Nga fillimi i dhjetorit 2016 u bë një operacion. Unë atë ditë kisha lëvizur nga shtëpia pasdite sepse paradite isha aty. Kur mora vesh se në shtëpinë time kishin shkuar shumë policë dhe kishin bërë kontroll, normale që në atë moment u fsheha.

**Pse e menduat shmangien nga arrestimi, si zgjidhjen më të mirë? Për çfarë motivi?**

Për motivin se nuk kisha prova këtu dhe unë mund të qëndroja në burg derisa të vinin provat ose derisa të mbaronte çështja në Greqi.

**Fare mirë mund të qëndronit në burg dhe të ishit përballur me drejtësinë, nëse ju jeni i bindur që nuk ka prova kundër jush.**

Drejtësia nuk kishte dokumentet e duhura, që të më dërgonte në gjykatë dhe unë të përgjigjesha përballë drejtësisë.

**Pas më shumë se 2 vitesh e gjysmë, ju keni vendosur që t'i përgjigjeni thirrjes së drejtësisë dhe të dorëzoheni. Pse pikërisht në këto momente?**

Po se në këto momente kam marrë një informacion, një njoftim nga avokati, që ka ardhur dokumentacioni, siç e kam dëgjuar edhe në media, pra kanë ardhur dokumentet për t'u gjykuar, që çështja ime i kalon drejtësisë shqiptare. Nga ky moment që çështja ime i kalon drejtësisë shqiptare, unë e kam deponuar edhe vetë më përpara që nëse çështja i kalon drejtësisë shqiptare, unë jam i gatshëm që të dorëzohem në çdo moment. Nga ky moment që çështja ime i kalon drejtësisë shqiptare, unë jam i gatshëm që t'i paraqitem drejtësisë.

**Kur vendosët që të dorëzoheshit? Si i vendosët kontaktet me policinë, në ç'formë? Tani që po flisni ju jeni ende i lirë, pra si kontaktuat me policinë?**

Pjesëtarët e familjes kanë kontaktuar me policinë dhe i kanë thënë që në datën 15, që i bie nesër, të vijnë e të më marrin në shtëpi. Dhe unë jam paraqitur sot në shtëpi që nesër t'i dorëzohem policisë.

**Nuk mendoni që në momentin që do të**






**dorëzoheni, mund të fillojnë përsëri akuzat që janë bërë kundër jush?**

Në momentin që kanë ardhur provat, unë iu paraqita drejtësisë. Se çfarë provash janë, se çfarë akuzash janë do t'i tregojë drejtësia.

**A jeni në dijeni që në adresën tuaj ka një vendim në Greqi, që jeni dënuar me burgim të përjetshëm në Greqi?**

Jo, jo. Greqia nuk ka burgim të përjetshëm për hashash dhe unë nuk jam i dënuar.

**Pse jeni i sigurt që nuk jeni dënuar?**

Sepse kam një avokat për çështjen time që më ka mbrojtur.

**Avokat shqiptar apo grek?**

Grek.

**Sepse ambasadori amerikan Lu ka deklaruar ...**

Çështja vazhdon që të jetë në proces gjyqësor në Greqi, nuk ka mbaruar.

**Pra ju jeni i bindur që deri tani nuk ka dënim ndaj jush nga pala greke?**

Çështja është në procese gjyqësore.

**Gjatë kësaj kohe, ju keni qenë njeriu më i akuzuar në Shqipëri. Dhe për më tepër nofka "Eskobari i Ballkanit" ka bërë që emri juaj të ishte në krye të listës së personave më të kërkuar në Republikën e Shqipërisë.**

Ajo dihet që ishte politizuar.

**Por ajo që i dha më tepër peshë akuzave kundër jush ka qenë pikërisht përmendja e emrit tuaj nga ambasada amerikane...**

Ambasada është ndikuar nga politika shqiptare, që më ka bërë këtë sepse unë nuk kam lidhje as me DEA-n siç më akuzon DEA, dhe as me ambasadën, se unë akuzohem për 600 kg hashash të kapura në Zakintho i dyshuar.

**A e dini ju që për 2 vite e gjysmë keni qenë njeri shumë i kërkuar edhe për agjencinë amerikane të antidrogës DEA?**

## AKUZA

> "Ambasada është ndikuar nga politika shqiptare, që më ka bërë këtë sepse unë nuk kam lidhje as me DEA-n siç më akuzon DEA, dhe as me ambasadën, se unë akuzohem për 600 kg hashash të kapura në Zakintho i dyshuar".

Po, kam dëgjuar dhe ky ka qenë shkaku që unë nuk bë një bujë shumë e madhe dhe u politizua shumë. Dhe normale, si mund të dorëzohesha unë kur më akuzon si "Eskobar" për 600 kg hashash?

**Gjatë kësaj kohe keni marrë ndonjë informacion përse është përfshirë emri juaj në gjithë këtë histori, sepse ju pretendoni sot që në asnjë rast nuk jeni përfshirë në trafik të drogave të forta, që zakonisht janë elementët që heton DEA amerikane.**

As që bëhet fjalë fare.

**Atëherë, si është e mundur që është përfshirë emri juaj?**

Nuk e di. Politika, ndoshta. Nuk e di këtë se si është bërë.

**Nga aq sa keni kontaktuar me avokatët tuaj në Shqipëri dhe në Greqi, për çfarë episodesh jeni nën akuzë në Greqi?**

Për hashash, për punën e Zakinthos.

**Për ngarkesën me 600 kg kanabis.**

Po.

**Në deklaratën që policia e Athinës ka bërë në datën 10 maj të vitit 2016, thuhet që ju keni bashkëpunuar me vëllezërit Poti, nga Kukësi, të arrestuar në Belgjikë. A i njihni këta persona?**

As që i kam dëgjuar ndonjëherë. As i kam parë dhe as i kam dëgjuar ndonjëherë. Nuk më ka lidhur ndonjëherë puna që t'i njoh këta persona.

**Të kthehemi tek akuza që është bërë për rastin e Zaqithos. Aty thuhet që identifikimi juaj është bërë nëpërmjet numrit të serisë së një pasaporte. Çfarë ka ndodhur?**

Si mund të nis unë pasaportën time? Përse do ta nisja? Në qoftë se isha unë ai, për çfarë arsyeje do të nisja pasaportën? Është shumë e thjeshtë, shumë e logjikshme.

**Keni kontaktuar atë ditë me personin, i cili bënte transportin sepse në dosje thuhet që ju keni fikur telefonin sapo keni marrë vesh që diçka nuk shkonte.**

Jo, jo. Nuk është e saktë.

**E njihni ju personin i cili është ndaluar në Greqi?**

Këtë të Sarandës e njoh se ja ku është Saranda dhe ka popullsi të vogël, por thjesht si fytyrë. Kontakte nuk kam.

**Në çfarë rrethanash jeni njohur?**

Në asnjë rrethanë, nuk kam fare asnjë lidhje. Nuk kam kontakt me anjë nga ata persona.

**Në rastin konkret, numri telefonik të cilin policia greke pretendon që është përdorur nga ju, është i juaji apo jo?**

Jo. Le ta faktojnë. Unë nuk kam fare kontakt me atë lloj numri që më akuzojnë, nuk kam lidhje fare.

**Autoritetet greke janë të bindura që skafi, ngarkesa dhe skafisti atë ditë, kanë qenë duke bërë trafik për llogarinë tuaj.**

Për të vërtetuar këtë duhen prova.

**Pse jeni i bindur ju që nuk ka prova.**

E di që nuk kanë sepse di veten, njoh veten që nuk kam lidhje me atë punë dhe me atë grup. Kjo është krejt normale, si të mos jem i bindur. Unë e di veten se çfarë kam bërë.

**Deri në atë moment, ju me çfarë aktiviteti jeni marrë në Greqi? Keni pasur biznes atje?**

Jo. Asnjë biznes në Greqi.

**Keni shkuar në Greqi?**

Më parë, ka 5-6 vite, që në 2011-ën. Më pas nuk kam shkelur në Greqi.

**Ka një pretendim tjetër, në të cilin thuhet që një shtetas i huaj, i cili vinte nga Ekuadori, ka qenë duke trafikuar 23 kg kokainë në drejtim të kryeqytetit britanik Londër. Dhe këtu bëhet edhe lidhja që nga ky moment DEA ka filluar hetimet për emrin tuaj.**

Po çfarë lidhje?! As edhe një lidhje nuk ka. Mund ta provojnë dokumentacionet. Unë nuk kam fare lidhje dhe nuk njoh asnjë nga ata persona.

**Pas zgjedhjeve të vitit 2013, kur koalicioni i majtë PS-LSI erdhi në pushtet dhe u rrëzua nga pushteti PD-ja, ju u emëruat në pozicionin e drejtorit rajonal të transporteve. Pse shkuat pikërisht në atë vend? Ju morët pjesë në fushatë? Çfarë qëndrimi keni mbajtur?**

Familja ime ka kontribuar për këtë parti. Edhe unë kam kontribuar.

**Për kë parti?**

Për LSI-në. Kam kontribuar, pavarësisht se nuk jam ngatërruar me politikën, por kam ndihmuar thjesht familjarët. Dhe për këtë gjë m'u ofrua ky shpërblim, si post drejtori. Dhe unë e pranova dhe kam shërbyer në atë post. Nuk jam implikuar në korrupsion. Dhe kjo është një gjë që e faktojnë edhe provat.

**Gjatë kësaj kohe, pra nga viti 2013 deri në vitin 2016 kur ndodhi kjo, jeni përfshirë në aktivitete politike? Kanë qenë zgjedhjet lokale të vitit 2015. Ju si drejtues i rëndësishëm i një sektori në zonën e Sarandës dhe të Delvinës, gjatë kësaj kohe jeni përfshirë, duke pasur parasysh që nipi juaj kandidonte?**

Po, normal që jam përfshirë. Kam kontribuar.

**Fillimisht familja juaj ka mbështetur të djathtën, për shkak edhe të origjinës.**

Po.

**Nëse e kujtoni, e keni takuar ndonjëherë Sali Berishën?**

Po, para shumë kohësh, kur vinte në zonën e Delvinës. Ka kaluar në fshatin tim, ka ardhur edhe në banesën time. Unë kam qenë i vogël atëherë, e kam takuar, i kam dhënë edhe dorën. Vetëm atë person.

**Po më pas, kur ka qenë kryeministër?**

Jo, jo.

Mban mend ndonjë rast kur ka ardhur në Delvinë?

Kur ka ardhur në Delvinë një herë, ndoshta në vitin 2006.

**Jeni akuzuar sikur keni pasur lidhje direkte me kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama. Sidomos në vizitat që ai ka bërë në Sarandë dhe duke përfshirë qëndrimin që ai ka bërë apo vizitat që ka bërë në hotelin "Santa Quaranta" me ministrat e tij. Është filmuar aty. Si është kjo, çfarë ka ndodhur aty?**

Unë nuk kam lidhje me atë hotel, me atë pronë që më akuzojnë dhe nuk kam pasur ndonjëherë kontakt nga afër me Edi Ramën.

**Ju jeni akuzuar që jeni pronar aty.**

Është shumë e lehtë që të verifikohet kjo, mjafton që të shihen dokumentet e pronësisë. Unë nuk kam lidhje fare me atë pronë.

**Një nga akuzat kryesore të bëra edhe në media, ka qenë që për shkak të sigurisë që ka objekti, kamerat kanë filmuar, serveri është zhdukur. Si është kjo histori?**

Unë nuk kam lidhje fare dhe nuk mund të di se çfarë është bërë atje. Nuk jam unë pronari i hotelit. Hoteli është prona e vëllait. Unë mund të shkoj atje, por nuk mund të di se çfarë bëhet me punën e tij, me serverat etj.

## SHKURT

### Shtyhen 3 muaj hetimet për ish-ministrin Saimir Tahiri

**TIRANË** - Prokuroria e Krimeve të Rënda do të zgjasë edhe tre muaj hetimet për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Ky është vendimi që ka marrë organi i akuzës, i cili ka vendosur të shtyjë për të katërtën herë, afatin e hetimeve për Tahirin. Mësohet se afati i hetimeve do të përfundonte ditën e sotme. Ndërkaq, burime nga prokuroria bënë me dije se shtyrja e hetimeve është bërë me synim kryerjen e disa verifikimeve shtesë lidhur me çështjen për të cilën po hetohet. Mësohet se prokurorët e çështjes kanë administruar përgjigjet e letër-porosive të mbërritura nga Greqia, Italia dhe Mali i Zi. Por në Itali dhe Mal të Zi, prokuroria nisi dy kërkesa të reja për informacion, ku kërkohen materialet e dosjes në Katania dhe do verifikohet një udhëtim në 2014 i familjarëve të Tahirit. Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri është vënë nën hetim, si i dyshuar për lidhje me grupin "Habilaj" që merrej me trafik droge drejt Italisë.

### Skandali me 'DH Albania', Afrim Qëndro në prokurori

Drejtori i Autoritetit Rrugor, Afrim Qëndro ka dëshmuar ditën e djeshme për afro 2 orë në prokurorinë e Tiranës në lidhje me skandalin e firmës 'DH Albania', e cila do të ndërtonte lotin e parë të Unazës së Re. Firmë kjo që kishte falsifikuar dokumentet për marrjen e tenderit. Mësohet se kreu i ARRSH-së ka mbërritur në orën 11:00 të së në dyert e organit të akuzës së kryeqytetit ku është marrë në pyetje nga oficerët e Policisë Gjyqësore. Qëndro ka shpjeguar të gjitha procedurat e fituesit e lotit të parë tek "Unaza e Re". Ai ka dhënë shpjegime të detajuara lidhur me procedurat e ndjekura. Ndërkaq, kreu i ARRSH-së ka mohuar kategorikisht të këtë kryer shkelje, por ka respektuar ligjin për tenderin. "E kam bërë të ditur tërësinë e veprimeve që ka kryer ARRSH-ja në lidhje me projektin e unazës. Unë mendoj që nuk ka asnjë shkelje nga ARRSH-ja", është shprehur Afrim Qëndro para oficerit të policisë gjyqësore, Ludovik Ndoka. Ndërkaq, pas daljes nga organi i akuzës ai u shpreh se 'Erdha si drejtor. Nuk kam se çfarë të them, nuk ka asnjë shkelje, ARRSH nuk ka bërë asnjë shkelje'.

Lista e plotë/ Ja kur duhet të paraqiteni pranë Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë

# Kempi, zbardhen emrat e 289 personave që do të kryejnë kontrollet mjekësore

## *ISSH: Nëse nuk kryeni ekzaminimin, nuk mund të përfitoni pension*

Voltiza Duro

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka zbardhur emrat e personave që do t'i nënshtrohen kontrolleve mjekësore në KMCAP Epror gjatë muajit janar të këtij viti për të marrë pensionin. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot listën e plotë me emrat e 289 personave që duhet të kryejnë ekzaminimet brenda muajit pranë Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë. Këta individë, në rastin që nuk do t'i nënshtrohen kontrollit mjekësor, nuk do të mund të marrin apo rimarrin pensionin e invaliditetit nga ISSH. Të gjithë ata persona që bëhen të paaftë për çdo veprimtari ekonomike dhe kanë dëmtime fizike apo gjymtime të forta, duke përfshirë verbimin, iu lind e drejta për pension invaliditeti. Për të përfituar këtë lloj pensioni të plotë, të reduktuar dhe të pjesshëm, përfituesi ose i autorizuari me prokurë paraqitet në ALSSH të vendbanimit, sipas regjistrimit në gjendje civile, për të bërë kërkesën e përfitimit të pensionit të invaliditetit. Përfituesi për pension invaliditeti ose i autorizuari me prokurë, së bashku me kërkesën duhet të paraqesë dhe dokumentet që vërtetojnë moshën e identitetin, ato që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës si dhe dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara e gjendjen shëndetësore. Ky dokumentacion i dorëzohet mjekut të ekspertizës, i cili pas verifikimit njofton datën për të kaluar në KMCAP, ose i kthen mbrapsht dokumentet për pasaktësi. KMCAP në mbledhjen e tij shqyrton paraprakisht dokumentet, njofton dhe ekzaminon të sëmurin, merr vendimin përkatës jo në prani të tij, dhe kryetari i KMCAP-it ia komunikon zyrtarisht të sëmurit gojarisht dhe nëpërmjet vërtetimit tip. Kundër këtij vendimi i sëmuri ose invalidi mund të ankohet tek KMCAP-i epror. Ankesa bëhet me shkrim dhe dorëzohet në DRSSH përkatëse.

### LISTA E PERSONAVE QË DO TË PARAQITEN NË KMCAP EPROR PËR MUAJIN JANAR 2019

| Nr. | Emër | Mbiemër | KMCAP | Data | Ora | Rrethi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ➤ | **NEUROLOGJI** | | | | | |
| 1 | KADRI | SINAJ | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | KUKES |
| 2 | MIRELA | DANAJ | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | GJIROKASTER |
| 3 | ZAIM | KURUMI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | DIBER |
| 4 | BASHKIM | DALTI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | DIBER |
| 5 | QAZIM | PIRRA | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | DIBER |
| 6 | VLADIMIR | BERBERI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | KORCE |
| 7 | BESMIR | BLACËRI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | KORCE |
| 8 | VERA | KOLLÇINAKU | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | KORCE |
| 9 | MIRELA | GRAMI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | SHKODER |
| 10 | RODOLF | FILIPI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | SHKODER |
| 11 | GEZIM | SHAHINI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | SHKODER |
| 12 | KASTRIOT | PERGJERGJI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | LEZHE |
| 13 | FRAN | LASKA | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | LEZHE |
| 14 | MOIS | VELIA | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | LEZHE |
| 15 | LAVDIMIR | SHTJEFNI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | LEZHE |
| 16 | ZEF | NDRECA | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | LEZHE |
| 17 | RUDINA | PRIFTI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | VLORE |
| 18 | SHYQYRI | XHEZO | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | VLORE |
| 19 | DANIELA | LUSHO | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | VLORE |
| 20 | DASHURI | DELIU | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | BERAT |
| 21 | MYRVETE | META | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | BERAT |
| 22 | MARGARITA | SINANAJ | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | BERAT |
| 23 | DUDI | BAJRAM | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | FIER |
| 24 | BAJAME | DYRMYSHI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | FIER |
| 25 | KADRI | KONJA | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | FIER |
| 26 | MIHAL | RRUSHI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | FIER |
| 27 | MIMOZA | PETUSHI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | FIER |
| 28 | FESTIM | BRAHIMAJ | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | FIER |
| 29 | BARJAM | GRECA | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | FIER |
| 30 | LUMTURI | GJEKA | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | FIER |
| 31 | PETRIT | MYRTAJ | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | FIER |
| 32 | SHKELQIM | BRAÇELLARI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 33 | EVGJENI | THANO | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 34 | QAMIL | BALI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 35 | ISUF | MANI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | DURRES |
| 36 | SULLTANE | BARUNI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | DURRES |
| 37 | XHAVIT | QOSHJA | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | DURRES |
| 38 | DALIP | KALLAKU | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | DURRES |
| 39 | NATASHA | CANI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | KAVAJE |
| 40 | RAJE | HASALLIU | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | TIRANE |
| 41 | EDMOND | NIKOLLI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | TIRANE |
| 42 | ESTREF | QOSE | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | TIRANE |
| 43 | SELAMI | SHTINO | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | TIRANE |
| 44 | ARGJIRO | SHTYLLA | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | TIRANE |
| 45 | ARBEN | GJATA | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | TIRANE |
| 46 | LUMTURI | HAZIZI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | TIRANE |
| 47 | ISA | TOSKA | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | TIRANE |
| 48 | ISMAIL | ÇALI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | TIRANE |
| 49 | NATASHA | XHELALI | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | TIRANE |
| 50 | MUHAFER | MEMISHAJ | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | TIRANE |
| 51 | PETRIT | SHIMA | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | TIRANE |
| 52 | MAMICA | SIMUTA | NEUROLOGJI | 22,01,2019 | 08,00 | TIRANE |
| ➤ | **PATHOLOGJI** | | | | | |
| 53 | MAJLINDA | TARTARAJ | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | GJIROKASTER |
| 54 | ZEMRIJE | ZEQJA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 55 | MATJETA | MATA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 56 | KUMRIJE | CEVANI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 57 | LAVDI | HASA. | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 58 | AGIM | KALECI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 59 | VIKTORI | HAMATI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 60 | MIMOZA | FRASHERI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 61 | AFERDITA | AGOLLI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 62 | NIKO | MANO | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 63 | ROZETA | SHAHOLLI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 64 | ARTAN | GUÇE | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 65 | XHEVDET | METE | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 66 | NIKO | BABI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 67 | LILJANA | AJDINI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 68 | ARTUR | JANAQ | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 69 | XHEMILE | KRASTA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 70 | SARE | HOXHA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 71 | HIQMET | ABESHI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 72 | LINE | BREGU | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 73 | ADEM | HYSENI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 74 | VALDETE | SEFERAJ | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 75 | LODOVIK | DEDA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 76 | ARIOLA | CENI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 77 | ZEF | SHKOZA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 78 | PETRAQ | BIBA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | VLORE |
| 79 | KAJACE | FILAJ | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | VLORE |
| 80 | NJAZI | LAMAJ | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 81 | DORJANA | RANGA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 82 | ALFONS | QATO | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 83 | LINDITA | RAMA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 84 | EDMOND | LLESHAJ | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 85 | GJIN | KOLA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 86 | IDRIZ | TAFA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 87 | SANE | SINANI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 88 | LAVDIM | KARAJ | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 89 | HANE | KOTORRI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 90 | BURBUQE | HOXHA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 91 | FATMIR | CANI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 92 | HAVA | TOPI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 93 | MIRANDA | BOSHKU | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 94 | XHEVAT | BURRAJ | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 95 | GENTJANA | LILO | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 96 | ANIBAL | BASHA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 97 | MUSTAFA | SHEHI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 98 | MIMOZA | MULLETI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 99 | SHKURTE | BUZHIQI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 100 | NDOC | GJOKA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 101 | AFERDITA | XHEKA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 102 | ASLLAN | BREGU | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 103 | ERMIRA | HOXHA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 104 | VASILIKA | LAMI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 105 | OSMAN | SELI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 106 | MELI | BANO | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 107 | FATMIRE | ÇAKRRI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 108 | BUJAR | GOGA | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 109 | MUHARREM | BRUÇI | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 110 | SABRIJE | TURKU | PATHOLOGJI | 23.01.2019 | 08,00 | KAVAJE |
| ➤ | **KARDIOLOGJI** | | | | | |
| 111 | FOTO | ÇILI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | SARANDE |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 112 | BAJRAM | SHUAIPI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | SARANDE |
| 113 | LIZË | PALOKA | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | SARANDE |
| 114 | MISTO | QORRI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | GJIROKASTER |
| 115 | BASHKIM | GJOKA | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 116 | GENTJAN | NDREU | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 117 | VALENTINA | GRAZHDANI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 118 | RAFIZAN | ETHEM | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 119 | BARJAM | MEKOLLI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 120 | ANDON | ANDONI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 121 | RESMIJE | GALLA | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 122 | KOSTAQ | VINÇANI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 123 | ANDON | HOXHALLI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 124 | KASËM | ZYLALI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 125 | JETNOR | NAZIFI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 126 | VELI | ÇEÇI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 127 | LUAN | REZHDA | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 128 | NAMIK | MYRTOLLARI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 129 | BURHAN | ZJARMI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 130 | SYME | HARAPEJ | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 131 | ZEF | RRANXBURGAJ | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 132 | SMAJL | ÇALLAJ | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 133 | KASËM | SPAHIJA | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 134 | LAZËR | ARAPI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 135 | DED | ALIA | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 136 | ZENUN | VESELI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 137 | JAK | ZEFI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 138 | GJIN | MOLI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 139 | LEK | CARI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 140 | LEK | MARKU | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 141 | BARDHOK | PERLIKA | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 142 | PJETËR | PERSHPALI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 143 | LEK | LLESHI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 144 | GALENTINA | FISHEKAJ | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | VLORE |
| 145 | FATOSH | ZANAJ | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | VLORE |
| 146 | ANTONETA | MEZINI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | VLORE |
| 147 | GANI | MEMA | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 148 | HANEMSHA | CJAPI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 149 | NESHAT | MUHAMETI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 150 | PETRIT | ISMAILI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 151 | YZEIR | DEMAJ | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 152 | PETRAQ | BOJAXHI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 153 | AGIM | KANAÇI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 154 | BLEDAR | ÇUÇAJ | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 155 | MEHMET | SELIMI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 156 | ISUF | MERKO | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 157 | FETI | BEQAJ | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 158 | ARDIAN | BUDO | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 159 | HAMITE | MEHMETAJ | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 160 | PËLLUMB | IMERALILAJ | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 161 | RESMIJE | ÇARÇIU | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 162 | KUJTIM | BAKIU | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 163 | LULE | ALLKJA | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 164 | VIKTOR | GJATA | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 165 | AGRON | LUFTA | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 166 | PETRIT | ZENELI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 167 | ASTRIT | ILJAZI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 168 | BAJRAM | QYLAFI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 169 | DASHAMIR | SADIKU | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 170 | PETRIT | NEZAJ | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 171 | DHIMITËR | LLAZARI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 172 | LUAN | HASA | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 173 | LUAN | PALAMANI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 174 | FERDINANT | TAIROLLARI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 175 | FATMIR | KONI | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 176 | ALBERT | TALO | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 177 | DURIM | DUSHKU | KARDIOLOGJI | 30.01.2019 | 08,00 | KAVAJE |

➤ **KIRURGJI**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 178 | LULJETA | ISUFI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | SARANDE |
| 179 | MUDIR | HOXHA | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | GJIROKASTER |
| 180 | ZAMIRA | NGOTA | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 181 | ZAMIRA | GAZIDEDE | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 182 | LIRIANA | LLANGOS | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 183 | FERQETE | SHULI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 184 | FATBARDHA | NAZIFI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 185 | LJUBA | HOXHALLI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 186 | THANAS | MILIKU | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 187 | AKSINJE | MEÇE | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 188 | ANDREA | MEHMETLLARI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 189 | TIXHE | SKURRAJ | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 190 | PETRIT | VOLAJ | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 191 | LIRIJE | BAJRAKTARI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 192 | FLUTURA | ALIJA | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 193 | LEK | KACOLI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 194 | PREK | NDREU | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 195 | DAVE | NDOJ | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 196 | FLORA | DEDA | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 197 | FESTIM | KASO | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | VLORE |
| 198 | RAMADAN | FETA | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | VLORE |
| 199 | NEKIE | HAXHIRAJ | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | VLORE |
| 200 | KAJAÇE | MYFTARAJ | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 201 | METO | ÇELA | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 202 | MERITA | KASTRATI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 203 | NATASHA | KALOTI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 204 | SHPETIM | ZYKA | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 205 | SYME | MECI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 206 | AGIM | HODO | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 207 | ARTUR | KOPILI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 208 | AGIM | HIMÇI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 209 | NAIM | GJONI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 210 | YLLI | META | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 211 | SHKELQIM | BRAÇJA | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 212 | MERITA | VELECJA | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | KAVAJE |
| 213 | VIOLETA | TILA | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 214 | MIMOZA | BUDA | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 215 | AISHE | VELIAJ | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 216 | BLERIME | GRORI | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 217 | PALI | NIKBIBAJ | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 218 | ILIRJAN | DAKO | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 219 | NADIRE | HIDA | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 220 | LUMTURIE | DEMA. | KIRURGJI | 18.01.2019 | 08,00 | TIRANE |

➤ **ORTOPEDI**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 221 | SELFO | LESKAJ | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | SARANDE |
| 222 | SHPRESA | NUHIALLARI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KUKES |
| 223 | KUJTIM | LLORJA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 224 | URIM | GJOKA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 225 | HAMZA | SHIRA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 226 | ELIVERTA | KAPE | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 227 | RITVAN | PANE | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 228 | SYBI | PERONA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 229 | ADELINA | ÇELNIKU | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 230 | NEXHMIJE | LEKA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 231 | QAMILE | ÇORBAXHI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 232 | SALI | AGO. | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 233 | KADRI | GJIRITI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 234 | LIRIJE | SINO | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 235 | LUMTURIE | GUÇE | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 236 | LORETA | MAXHA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 237 | ZAMIRA | SHAQIRI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 238 | MUIS | SEITAJ | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 239 | FLORE | DURGAJ | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 240 | BESNIK | KUKAJ | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 241 | ZOJE | NIKAJ | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 242 | LEZE | SHABAJ | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 243 | DRANDE | TAVASJA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 244 | TEUTA | PIRANI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 245 | ZEF | FUSHA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 246 | FATMIR | BOFJA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 247 | ZEMRIJE | TAFA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 248 | GJYSTE | QEFALIAJ | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 249 | GJET | LLESHI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 250 | SOFIJE | ELEZI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 251 | BARDHOK | PERLEKA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 252 | MARK | NILI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 253 | MAJLINDA | FETIU | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 254 | KRENAR | SPAHO | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 255 | GEZIM | METOHU | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 256 | SKENDER | HOXHA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 257 | PETRAQ | GOPO | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 258 | QERIM | SHEHAJ | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | FIER |
| 259 | ELTON | XHELILI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 260 | SOFIJE | ZANI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 261 | NADIRE | BULLARI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 262 | BASHKIM | ALLA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | DURRES |
| 263 | SHERIF | DACI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | DURRES |
| 264 | FLORIND | DAIU | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | KAVAJE |
| 265 | MYSLYM | KAZA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 266 | LINDITA | PRENGA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 267 | MUSTAFA | ZEQIRI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 268 | PASHANE | LITA | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 269 | HAVE | KASTRATI | ORTOPEDI | 25.01.2019 | 08,00 | TIRANE |

➤ **PSIKIAT/OCULIST**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 270 | SINAN | HABIPI | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | GJIROKASTER |
| 271 | BESNIK | DELIU | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 272 | ANTONETA | NURÇE | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 273 | NATASHA | GJOKA | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | DIBER |
| 274 | PETRIT | REXHEP | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 275 | VALBONA | SHESHMINA | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 276 | LUAN | FEJZO | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | KORCE |
| 277 | SABRIJE | KRAJA | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | SHKODER |
| 278 | ROVENA | MAMURANI | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | BERAT |
| 279 | GEZIM | UKA | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 280 | LUAN | KADIU | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 281 | BIB | BECI | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | LEZHE |
| 282 | ZYBER | TARKO | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | ELBASAN |
| 283 | SANIJE | XHAMANI | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | KAVAJE |
| 284 | XHEVRIJE | MEHIDRI | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 285 | VJOLLCA | KOXHA | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 286 | BLERINA | SHKRETA | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 8,00 | TIRANE |
| 287 | ARTUR | KURA | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 288 | SABRI | TAHIRI | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | TIRANE |
| 289 | ILIRJAN | ALLA | PSIKIAT/OCULST | 29.01.2019 | 08,00 | TIRANE |

## PROTESTA E STUDENTËVE

### KOKA

"Janë shpërdoruar fondet për luks zyrash e makina. Paniku i Maturës Shtetërore"

# Mbledhja te Filologjiku: Pse duhet të rrëzohet ligji për arsimin e lartë

## *Rigels Xhemollari: Të ndëshkohen të korruptuarit*

Voltiza Duro

*Studentët e Histori-Filologjisë kanë zhvilluar një takim ditën e djeshme (brenda ambienteve të fakultetit ku janë ngujuar) për të diskutuar mbi problematikat e arsimit të lartë në vend. I pranishëm në këtë diskutim ishte edhe drejtori ekzekutiv i organizatës rinore "Qëndresa Qytetare" Rigels Xhemollari. Ky i fundit në një intervistë për 'Gazeta Shqiptare' tregon se në takim u diskutua mbi problematikat e ligjit për arsimin e lartë, kartën e studentit, korrupsionin në universitete dhe peshën e votës studentore në përzgjedhjen e strukturave drejtuesve të IAL-ve publike në vend. Xhemollari thekson se studentëve iu mungon garancia se kërkesat e tyre do të plotësohen nga qeveria. Ndërkohë sipas studimit të 'Qëndresa Qytetare', përgjatë vitit akademik 2017 - 2018 për 3 universitete u zbuluan një sërë të dhënash që faktojnë shpërdorimin e madh të parave të studentëve nga bordet e administrimit për shpenzime luksi për zyrat e titullarëve, për kompanitë e sigurimit dhe për makina. Për sa i përket Maturës Shtetërore, drejtuesi i organizatës tregon se ky sistem ka dëmtuar në thelb meritën dhe preferencën e studentëve, duke i hequr departamenteve të drejtën ligjore për të përzgjedhur studentët, duke zhvilluar 9 faza paniku për pranimet në universitete dhe duke shpikur një instrument antiligjor si portal U-Albania për të bërë shortin e maturantëve. Xhemollari shton se pandëshkueshmëria e korrupsionit në arsimin e lartë është problem i gjithë sistemit duke filluar nga ministri deri tek pedagogu.*

**Ditën e sotme (djeshme) ju ishit të pranishëm në takimin e organizuar nga studentët e Histori-Filologjisë. Cilat ishin shqetësimet e tyre?**

I ftuar në cilësinë e aktivistit të Qëndresës Qytetare bashkë me studentët e Fakultetit të Histori-Filologjisë ndamë shqetësimet e tyre lidhur me pasigurinë e përgjysmimit të tarifave të shkollimit, mungesën e shërbimeve në universitete, zbatimin e ligjit 80/2015, barrierat e tyre financiare dhe të ardhmen e tyre drejt tregut të punës. Studentët, të cilët vazhdojnë bojkotin dhe protestën e tyre brenda auditorëve ju mungojnë garancitë se kërkesat e tyre do të plotësohen nga qeveria, ju mungojnë garancitë se këto politika do jenë të qëndrueshme dhe jo sa për të neutralizuar protestën.



Rigels Xhemollari

**Studentët kërkojnë rrëzimin e ligjit për Arsimin e Lartë. Ku çalon ky ligj sipas studimeve që ju keni bërë?**

Si jurist e di shumë mirë që një ligj të rrëzohet duhet të kemi një alternativë tjetër më të mirë se ai, dhe një ligj alternativ duhet të vijë si pasojë e një turi konsultimesh me stafet akademike, studentët dhe grupet e interesuara në një periudhë jo më pak se një vit akademik. Ky ligj duhet të vijë në funksion të zgjidhjes së problemeve të studentëve jo në funksion të interesave të jashtme private. Nisur nga studimet tona aspektet ku ligji për arsimin e lartë ka çaluar janë këto: në nivel menaxhimi dhe financimi universitetet kanë dështuar të plotësojnë nevojat e studentëve duke shpërdoruar në makina, naftë dhe kontrata abuzive paratë e tyre të instrumentuara nga bordet e administrimit. Në nivel akademik ligji ka dështuar të zbatohet duke mos financuar kërkimin shkencor, duke bllokuar kuotat e doktoraturave për 6 vite dhe duke bllokuar institucionet e reja si QSHA, ASCAL apo AKKSHI për 3 vite për shkak të mungesës së akteve nënligjore.

**PANDËSHKUESHMËRIA**

"Fakti që prokuroria, policia apo strukturat e vetë universiteteve nuk kanë nisur asnjë hetim apo verifikim për këto emra, situata paraqitet jo e mirë. Fundi i të korruptuarve duhet të jetë ndëshkimi dhe jo shkarkimi nga detyra",-thotë Xhemollari.

**Sa e rëndësishme është vota e studentëve në zgjedhjen e rektorëve apo dekanëve?**

Në zgjedhjet e zhvilluara në vitin 2016 për strukturat akademike asnjë rektor apo dekan nuk u zgjodh për shkak të peshës së votës së studentëve pasi kjo e fundit ishte 10% e peshës së totale të votave. Rritja e peshës së votës garanton zgjedhjen e rektorëve dhe dekanëve përfaqësues, i jep fund rokadave të vetë pedagogëve që zgjedhin njëri- tjetrin dhe rrit pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje. Sa i përket deklaratës së kryeministrit se nuk ka modele ku kjo e drejtë është më e lartë, jo vetëm që ka, por nëse i referohemi ligjit të 2007 për arsimin e lartë, pasha e votës së studentëve ishte 20% dhe ligjet shpesh duhet minimnalisht t'u referohen atyre paraardhës.

**Çfarë përfitimesh do të sillte karta e studentit?**

Karta e studentit duhet të ishte miratuar në vitin 2015, por që për shkak të vonesës së akteve nënligjore ende nuk është bërë e mundur për studentët. Referuar shembujve ndërkombëtarë një student mund të përfitojë nga karta e studentit ulje në ushqimin e ofruar në mensat e universitetit, akomodimi me çmim të reduktuar në konvikte, ulje në abonimet mujore për transportin publik, ulje në sigurancionin shëndetësor, përdorimi falas i ambienteve sportive, ulje të shërbimeve në kinema, teatro, koncerte, muze, biblioteka etj.

**Ku qëndrojnë problematikat në sistemin e Maturës Shtetërore. A është një proces transparent i bazuar në meritokraci?**

Matura shtetërore ka dëmtuar në thelb meritën dhe preferencën e studentëve, duke i hequr departamenteve të drejtën ligjore për të përzgjedhur studentët, duke zhvilluar 9 faza paniku për pranimet në universitete dhe duke shpikur një instrument antiligjor si portal U-Albania për të bërë shortin e maturantëve. Studenti duhet të njihet me lëndën, profesorët, kriteret, dhe profesionin që ai fiton pasi mbaron studimet. Këto faza kjo lloj mature i shmang duke i shkaktuar ankth dhe pasiguri maturantëve.

**Sa i pranishëm është korrupsioni në universitete dhe a verifikohen apo ndëshkohen pedagogët që marrin para në këmbim të notës?**

Qëndresa Qytetare prezantoi në muajin nëntor raportin mbi korrupsionin pedagog - student ku në fakultete ky fenomen pranohej në masën 70% nga studentët. Më pas nga protesta studentore vetë studentët e guximshëm nxorën në bulevard emra, foto dhe çmime tarifash provimi nga pedagogët e tyre. Fakti që prokuroria, policia apo strukturat e vetë universiteteve nuk kanë nisur asnjë hetim apo verifikim për këto emra situata paraqitet jo e mirë. Pandëshkueshmëria në arsimin e lartë është problem i gjithë sistemit duke filluar nga ministri deri tek pedagogu. Fundi i të korruptuarve duhet të jetë ndëshkimi dhe jo thjesht shkarkimi nga detyra.

**Si janë menaxhuar fondet për universitetet këto vitet e fundit, a ka patur shpërdorim të fondit nga bordet e administrimit?**

Nga monitorimi ynë për vitin akademik 2017 - 2018 për 3 universitete u zbuluan një sërë të dhënash që faktojnë shpërdorimin e madh të parave të studentëve nga bordet e administrimit për shpenzime luksi për zyrat e titullarëve, për kompanitë e sigurimit dhe për makina. Edhe në këtë rast zgjidhje nuk është vetëm shkarkimi i anëtarëve të bordit nga detyra, por edhe shkarkimi i tyre nga pozicionet e rëndësishme drejtuese që mbajnë dhe dërgimi përpara prokurorisë, në mënyrë që këta persona konkretisht me emra dhe mbiemra të mbajnë përgjegjësi ligjore dhe morale përpara studentëve.




**3**

**UNIVERSITETE SHPËRDORIM PARASH**

Nga monitorimi ynë për vitin akademik 2017 - 2018 për 3 universitete u zbuluan një sërë të dhënash që faktojnë shpërdorimin e madh të parave të studentëve nga bordet e administrimit për shpenzime luksi për zyrat e titullarëve, për kompanitë e sigurimit dhe për makina.

**70%**

**KORRUPSION NË UNIVERSITETE**

Qëndresa Qytetare prezantoi në muajin nëntor raportin mbi korrupsionin pedagog - student ku në fakultete ky fenomen pranohej në masën 70% nga studentët. Më pas vetë studentët e guximshëm nxorën në bulevard emra, foto dhe çmime tarifash provimi nga pedagogët e tyre.




## Ngujohet Durrësi, Elbasani e Shkodra

# Studentët e rretheve bojkotojnë mësimin: Pedagogët na kanë kërcënuar me mungesa

Protestës së studentëve të Tiranës, i janë bashkuar edhe një pjesë e studentëve të Elbasanit, Durrësit e Shkodrës. Edhe në qytetin e Elbasanit studentët vijojnë të protestojnë dhe një prej tyre sot ka denoncuar një kërcënim, që sipas tij, ka ardhur nga pedagogët e universitetit "Aleksandër Xhuvani". Pas orës 10:00 të ditës së djeshme një grup studentësh protestues që u ngujuan pasditen e të martës në ambientet brenda godinës kryesore marshuan drejt Fakultetit të Shkencave Teknike Mjekësore duke kërkuar solidaritetin e kolegëve. Me protestuesit u bashkuan një numër i vogël studentesh, ndërkohë që në mbrëmje studentët i janë rikthyer ngujimit. Nga ana tjetër, në auditore është konstatuar shtim i studentëve që ndjekin leksionet dhe seminaret. Një student i Fakultetit të Infermierisë në Elbasan shprehet se ata janë kërcënuar me mungesa nga pedagogët. Kjo sipas studentit Visar Jashari, është në kundërshtim të plotë me urdhrin e dekanit, i cili kishte njoftuar më parë se mungesat e tyre nuk do të merren.



**PROTESTË NË DURRËS**

Studentët e kampusit universitar në Durrës janë shprehur të bindur për të vijuar me bojkotin mësimor. Në ditën e dytë të protestës pati edhe studentë që iu drejtuan auditorëve, ndërsa protestuesit këmbëngulin në plotësimin e 8 kërkesave nga ana e kryeministrit Edi Rama.

Krahas Elbasanit, protesta vijon edhe në disa fakultete në Tiranë, ku studentët kanë zgjedhur të ngujohen brenda ambienteve deri në përmbushjen e kushteve.

## Përplasje tek Ekonomiku/ Nuk lejohet hyrja e administratës brenda godinës

# Studentët: Na kërcënuan në shesh, u ngujuam në fakultete

## *Kristiana Kola: Rezistenca jonë do të vazhdojë*

Voltiza Duro

Një pjesë e studentëve të universiteteve të kryeqytetit vazhdojnë të ngujuar brenda godinave të fakulteteve të tyre. Ata shfaqen të vendosur në vazhdimin e kësaj forme të protestës deri në plotësimin e 9 kërkesave të tyre, veçanërisht rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë. Mëngjesi i djeshëm ka nisur me përplasje te Ekonomiku ku rreth 100 studentë të ngujuar kanë bllokuar derën, madje kanë nxjerrë jashtë edhe punonjësit e administratës. Ndërkohë studentët e Fakultetit të Drejtësisë me anë të një letre i janë drejtuar pedagogëve dhe kanë dënuar dhunën e ushtruar disa ditë më parë nga Policia e Shtetit dhe ajo private. Ata më tej kanë kërkuar mbrojtje nga pedagogët e tyre në mënyrë që mos t'u digjet viti shkollor.

**NGUJIMI**

Deri më tani janë ngujuar brenda fakulteteve studentët e Drejtësisë, Ekonomikut, Filologjikut, Shkencave Sociale, Shkencave të Natyrës në UT si dhe ata në universitetin e Mjekësisë, Bujqësorit e Politeknikut. "Korpusi është "pushtuar" nga studentët që ditën e hënë. Dyert janë bllokuar ditën e parë për administratën ndërsa dy ditët e tjera kanë qenë hapur për administratën. Studentët kanë qëndruar gjatë gjithë ditës brenda, duke ndryshuar turne Rojet e sigurimit kanë bashkëpunuar me ne dhe situata ka qenë paqësore, sepse studentët kanë premtuar që nuk do ketë asnjë dëmtim brenda godinës",-thotë një prej studenteve të UPT për 'Gazeta Shqiptare'. Kjo e fundit thekson se disa studentë janë nxitur nga pedagogët për ti dhënë fund bojkotit e për të vijuar mësimin normalisht. "Një pjesë e studentëve janë nxitur nga disa pedagogë për vazhdimin e mësimit pas urdhrit të Rektoratit për nisjen e mësimit. Dekanët e FIM dhe FIE kanë patur komunikim me studentët por rektori jo. Ngujimi është zgjedhur si një metodë më e mirë proteste për shkak se universitetet nuk kanë shprehur mbështetje reale për protestën në shesh dhe kanë patur metoda për të frikësuar studentët që ishin jashtë auditorëve. Mund të themi që në këto momente protesta i drejtohet jo vetëm kryeministrit, por edhe vetë stafit universitar, i cili ka penguar të drejtën e studentëve për të vazhduar me protestën për vazhdimësinë e protestës",-tregon më tej studentja për 'GSH'.



Studentët e Fakultetit të Ekonomikut gjatë ditës së djeshme

**METODAT E KËRCËNIMIT**

Ngujimi është zgjedhur si një metodë më e mirë proteste për shkak se universitetet nuk kanë shprehur mbështetje reale për protestën në shesh dhe kanë patur metoda për të frikësuar studentët që ishin jashtë auditorëve",-tregon më tej studentja për 'GSH'.

**SITUATA TE SHKENCAT SOCIALE**

Edhe studentët e Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës vazhdojnë ngujimin brenda fakultetit deri në plotësimin e kërkesave.

"Gjatë okupimit të Fakultetit të Shkencave Sociale studentët kanë organizuar dhe kanë zhvilluar ligjërime me pedagogë të degëve të ndryshme që mbështesin kauzën tonë dhe aktivitete të tjera artistike si leximi i veprave poetike dhe eseve të krijuara nga studentët, disa studentë kanë shfaqur talentin e tyre në fushën e muzikës dhe janë shfaqur filma e dokumentare me tematikë lëvizjet studentore në mbarë botën",-thotë studentja Kristiana Kola për 'Gazeta Shqiptare'. Kjo e fundit shton se kanë pasur mbështetje maksimale nga ana e pedagogëve. "Kemi pasur një mbështetje për t'u marr shembull nga pedagogët tanë dhe jemi të vendosur që okupimi do vazhdojë derisa të plotësohen kërkesat tona. Rezistenca jonë do të vazhdojë, studentët e bashkuar kanë për të fituar",-thekson studentja e Shkencave Sociale.

**Shoqeria permbarimore JUSTITIA**

Shoqeria permbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e TRETE , për shitjen e pasurisë së paluajtshme per te cilen ka vene hipoteke NBG BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:

Lloji i pasurisë Are+ Truall (magazine dy kate) me sip. arë 3000 m2 / truall 1661/ ndërtesë 234.9, me nr.pasurie 58/9 vol 8 fq78, zk.1475 , Derven, KRUJË në pronësi të .Haki Ahmet MAVRIQI Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 60.480 (gjashtëdhjetë mije e katërqind e tetëdhjetë) EUR

Ankandi zhvillohet në datën 15.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor, me Adrese: Bulevardi"Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890




## Rama-studentëve: Ja ku mund të drejtoheni për sqarime

Në një kohë që studentët janë ngujuar në fakultete, kryeministri Edi Rama ka reaguar nëpërmjet një postimi në rrjetin social 'Facebook'.

Ai bëri me dije se ka vënë në dispozicion portalin "Shqiperiaqeduam.-al" për çdo student që kërkon sqarime.

"shqiperiaqeduam.al në dispozicion për çdo student që kërkon sqarime", shkruan Rama. Ditën e djeshme, duke folur gjatë aktivitetit për 'Bashkëqeverisjen me qytetarët', kreu i qeverisë Edi Rama tha se një dritare të veçantë për studentët do këtë edhe në faqen e Ministrisë së Arsimit në 'Facebook'. Kujtojmë se prej disa kohësh studentët janë ngritur në protestë ndërsa kërkojnë ulje të tarifave të shkollimit, plotësimin e kushteve në infrastrukturore, etj. Nga ana tjetër, kreu i qeverisë iu është përgjigjur duke nënvizuar faktin se për këto çështje kërkohet dialog.

Co-funded by the European Union

**VACANCY ANNOUNCEMENT**
**Project "Countering Serious Crime in the Western Balkans"**

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooper-ation for sustainable development.

**A. Project Description**
The project IPA/2017 "Countering Serious Crime in the Western Balkans" supports since January 2018 the Public Prosecution Offices (PPO's), Ministries of Justice, Ministries of Interior and police in the Western Balkan.
It is financed jointly by the European Commission and the Federal Ministry of Economic Cooperation and Development (BMZ) and implemented by the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusam-menarbeit (GIZ), Italian Ministry of Interior and the Center for International Legal Cooperation (CILC Netherlands).

The project's objective is to raise the effectiveness of and the cooperation among regional and na-tional institutions in fighting serious and organised crime. Combatting illegal migrant smuggling and recovering illegal financial gains obtained through diverse criminal acts are two examples on which the project will focus. Cooperation among investigation institutions of the countries, of the region and of the EU is crucial to improve overall security. Therefore, the project will support the conclusion and realization of cooperation agreements and enhance the use of communication means to better in-vestigate serious and organised crime across borders (for example, through so-called Joint Investi-gation Teams).

The project is unique in its practical approach. Each country is supported by a prosecutor and a police officer from EU member states as well as lawyers from the respective countries. These so-called embedded country teams advise the partner institutions in their ongoing operations and help them better investigate and prosecute serious and organised crime cases. This approach is advan-tageous because it allows the partner institutions to receive quick, high quality advice that takes EU best practices into account. In addition, short-term practical trainings on specific issues complement this support and empower police officers and prosecutors with specific capabilities and techniques they need in their daily work.
The project term is: Till March 2020

**GIZ office Albania seeks the following staff: Office Manager**
**B. Responsibilities**
The position holder is responsible for:
■ **Permanent interaction with the ECT/Focal Point for the ECT** (EU Prosecutor and Legal Advsior)
■ Provide administrative **support to the EU Prosecutor** in the implementation of area I and IV of the Action;
■ Provide administrative **support to the Legal Advisor** in the implementation of area II and III of the Action.

In this context, the position holder fulfils the following tasks:

**C. Tasks**
**1. Core scope of tasks**
■ Ensures the strict application of the GIZ rules and regulations;
■ Manages the daily accounting and manage both the Cash-book and Bank-book;
■ Maintains and administers the GIZ financial systems within the project in accordance with the guidance of the Head of Finance and Administration Officer, GIZ HQ book-keeping and financial controller;
■ Efficient processes of all local payments in compliance with GIZ and EU procedures and daily invoice checking, processing and record keeping;
■ Liaisons with the GIZ HQ in the country in relation to booking costs and checking invoices;
■ Ensures detailed financial records are kept in the formats needed for GIZ internal controlling, internal audits and for EU audits;
■ Monitors and regularly reports on the spent and planned resources;
■ Communicates with partners of the project;
■ Organises events, meetings, conference and trips with the region and to the EU

**2. Other duties/additional tasks**
The position holder

■ Has regular contact to the other project offices in the region;
■ Participates in Team Meetings outside the country
■ Is capable to work in a sensitive environment

**D. Required qualifications, competencies and experience**
**Qualifications**

■ **Education**: Bachelor's degree in economics/business or at least 4 years of relevant profes-sional experience
■ **Professional Experience:** At least 2 years of previous experience in accounting in the con-text of EU-funded projects
■ Languages: Excellent English Language skills
■ **Organisational skills**, experience with organizing events, meetings, conference and trips
■ **Proficient IT skills** (in particular: Word, Excel, SAP)

**Contract Conditions:**
- Full time employment
- Project office in Tirana
- **Assignment period until 31.12.2019**

Please forward your application until **27th of January 2019** to GIZ Office Albania by E-Mail: **giz-albanien-hr@giz.de** including the following information: Application letter, CV in Eng-lish (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

***GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!***

---

**Programme: Sustainable Regional and Economic Development, Employment Promotion and VET**

The *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit* GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooper-ation for sustainable development.

**A. Project Background**
Within the context of bilateral development cooperation, the Republic of Albania and the Federal Republic of Germany agreed on the joint implementation of the "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" program (short: ProSEED) in 2016. The overarching aim is to improve the employment situation of the workforce and self-employed, particularly of skilled youth, in the Albanian labor market.
The program currently runs from 01/2017 until 03/2022 and has five components: (i) Technical and Vocational Education and Training (TVET), (ii) Promotion of micro, small and medium-sized enter-prises (MSMEs), (iii) Social participation of youth and minorities, (iv) Strategies and frameworks for regional development, economic growth and employment and (v) Promotion of the innovation sys-tem.

In 2018 the European Union (EU) contributed funds under the framework of the Instrument for Pre-Accession Assistance 2020 for the Competitiveness and Innovation (C&I) Sector. The delegated agreement based co-financing extended the program by including measures to encourage innova-tive start-ups and to strengthening a corresponding environment (ecosystem) for start-ups and grow-ing companies. As such, a fifth component (see above) was added to the ProSEED program. The specific objective (outcome) of said component is "to improve the innovative eco-system and boost start-ups creation in Albania". In order to achieve the above-mentioned outcome, the interven-tion is structured in three Result Areas (RAs), out of which GIZ is responsible for RA1 and RA2. The activities under RA3 (Access to Finance and the Challenge Fund) are implemented by Sida in Tirana. RA1 and RA2 will be implemented within the institutional framework of the GIZ-ProSEED program, but will form an independent, separate structure with regard to objectives, operational planning and staff.

In order to communicate and present the objectives and achievements of this component/project, a Communication and Visibility Plan was agreed between the EU as main donor to the Action and GIZ/Sida as main implementing partners.
Furthermore monitoring of the achieved results of the component/project is key to their delivery. A joint monitoring system on the basis of the project's log frame and the results model will provide information on the state of implementation of the project as well as possible adaptation requirements.

**GIZ Office Albania seeks the following staff: Advisor - Communication and Monitoring**

**B. Tasks**
**In the areas of communication and public relations the Advisor performs the following tasks:**
■ Develops the communication strategy and coordinates the operationalization and imple-mentation of the strategy throughout the project
■ Elaborates a social media outreach strategy of the project (including a definition of the tar-get group and indicators of success) and coordinates the operationalization and implemen-tation of the strategy throughout the project
■ Maintains and updates the project's Facebook page and any other social media channels used by the project
■ Writes PR articles, reports and newsflashs on the project activities and achievements for internal and external communication (e.g. success stories)
■ Shoots and edits short videos on project activities shown on the project's website, on social media platforms or on other occasions
■ Supports layout and creation of fact sheets, roll-ups, poster, standard presentations and other material for the continuous promotion of the project
■ Coordinates all communication and visibility activities within the project and with other im-plementing partners, in particular with Sida, as well as with further organisations involved in the implementation of the project.

All communication materials developed and all activities undertaken shall be in accordance with EU's, GIZ's and Sida's corporate design principles.

**In the area of monitoring the Advisor performs the following tasks:**
■ Acts as focal person for all monitoring related questions within the project team
■ Ensures the regular update of monitoring templates in line with EU and GIZ requirements in close collaboration with technical advisors of the projects
■ Prepares regular monitoring workshops and supports the implementation of follow up activi-ties.
■ Delivers input to the various project reports/publications including annual reports in line with EU/GIZ requirements; contributes to other reports as required
■ Sets up the project's knowledge management system and taps into other knowledge man-agement systems

**C. Required qualifications, competences and experience:**

■ Education/training: University qualification in a relevant field (e.g. Journalism, Social Sci-ences)
■ General professional experience: at least 5 years of professional experience in communica-tion management, Media, Journalism or related field
■ Languages: Fluent in Albanian, excellent English language skills required (especially writ-ten skills)
■ Specific professional experience: Experience in journalistic writing and preferably in audio-visual media design, understanding of Monitoring and Evaluation standards and require-ments, high creative potential

**Contract conditions:**
■ Full-time employment
■ Project office in Tirana
■ Assigment period: until 30.09.2021

Please forward your application until **27th of January 2019** to GIZ Office Albania by E-Mail: **giz-albanien-hr@giz.de** including the following information: Application letter, CV in English (Eu-ropass format), references. Please include in your application **three work samples** such as written reports, articles or videos (please do not send videos directly but provide links) in English language.

Only short-listed candidates will be contacted or interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

***GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!***

### Masat që janë marrë për parandalimin e epidemisë

# Fruthi, 15 raste të konfirmuara brenda 15 ditësh. ISHP: Vaksinoni fëmijët



Brenda 15 ditëve të para të këtij viti, janë konfirmuar 15 raste të prekura nga fruthi, pjesa më e madhe e tyre poshtë moshës 2-vjeçare. Njoftimi është bërë ditën e djeshme nga Instituti i Shëndetit Publik, i cili i bën thirrje qytetarëve që të vaksinojnë fëmijët e tyre, pasi kjo është mënyra më e mirë e parandalimit. "Instituti i Shëndetit Publik informon qytetarët në lidhje me situatën e deritanishme të fruthit në vendin tonë dhe masat për të parandaluar përhapjen e tij. Për periudhën 1-15 janar 2019 janë raportuar në total 15 raste (pozitive) të konfirmuara me fruth. Nga rastet e konfirmuara në laboratorin e Institutit të Shëndetit Publik, pjesa më e madhe e rasteve i përkasin grupmoshës nën 2 vjeç. Për këtë arsye, ISHP ju bën thirrje të gjithë prindërve të vaksinojnë fëmijët e tyre, sipas Kalendarit Bazë të Vaksinimit, sepse është mbrojtja më e mirë për parandaluar fruthin si dhe për të ulur komplikacionet që vijnë prej tij",-thekson ISHP.

**15**

**RASTE ME FRUTH**
Nga data 1 deri në 15 janar të këtij viti, janë konfirmuar 15 raste të prekura nga fruthi. Njoftimi është bërë ditën e djeshme nga Instituti i Shëndetit Publik, i cili i bën thirrje qytetarëve që të vaksinojnë fëmijët e tyre, pasi kjo është mënyra më e mirë e parandalimit.

**MASAT PARANDALUESE**

Instituti i Shëndetit Publik ka ndërmarrë një sërë masash për mbrojtjen e qytetarëve nga epidemia e Fruthit. Këtu mund të përmendim: izolimi në pavione të caktuara (në pediatri dhe tek të rriturit) dhe vetëizolimi për rastet ambulatore; masa standarde të kontrollit të infeksionit dhe të transmetimit ajror; përdorim i maskave nga personeli dhe pacientët kur shkojnë në ekzaminime; vaksinim i personelit; monitorim i gjendjes mbrojtëse të personelit ndaj Fruthit; vaksinim brenda 72 orëve i kontakteve; vendosja e survejancës aktive në nivel kombëtar; si dhe trajnime me pjesëmarrjen e mjekëve të institucioneve parashkollore dhe shkollore si dhe mjekëve të familjes.

## Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit: Kërkohet nivel C1 për studime në ciklin e tretë

Voltiza Duro

# Testimet e gjuhëve të huaja që duhet të kaloni për studimet në master

## *Nivelet që duhet të keni për anglishten, italishten e frëngjishten*

Të gjithë ata që do të vazhdojnë studimet në ciklin e dytë apo të tretë në një prej IAL-ve publike e private, tashmë mund të njihen me nivelet dhe testet ndërkombëtare që duhet të plotësojnë për njërën prej pesë gjuhëve të huaja, në mënyrë që të pranohen në degën që preferojnë. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot udhëzimin e MASR si dhe tabelat përkatëse me nivelet dhe testet që duhet të kalojnë kandidatët për të vijuar më tej me studimet. "Udhëzoj përcaktimin e niveleve dhe testeve ndërkombëtare të 5 (pesë) gjuhëve të huaja, përkatësisht: gjuhës angleze, gjuhës frënge, gjuhës gjermane, gjuhës italiane dhe gjuhës spanjolle. Kandidatët, të cilët aplikojnë për t'u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë në institucionet e arsimit të lartë, duhet të kenë nivel të njohjes së njërës prej gjuhëve të huaja, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim",-thuhet në udhëzim. Në këtë të fundit theksohet se për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, ndërmjet nivelit B1 dhe nivelit C1. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloret e tyre nivelin e gjuhës, që do të jetë kriter hyrës në programet e studimit të ofruara prej tyre në ciklin e dytë. Për pranimin në programin e studimeve të ciklit të tretë, kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, të nivelit C1.

**CERTIFIKIMI**

Kandidati që aplikon për t'u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë në institucionin e arsimit të lartë, duhet të ketë certifikime dhe rezultate të testimeve ndërkombëtare për nivelet e njohjes së gjuhëve, brenda afateve të vlefshmërisë së certifikimeve të lëshuara. Ndërkohë dokumenti i njohjes së gjuhëve, mund të jetë një certifikatë, diplomë apo dëshmi, e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare. "Institucionet e arsimit të lartë duhet të shpallin në faqen zyrtare dhe ambientet e tyre: a) Listën e niveleve të njohjes së gjuhëve të huaja dhe testimeve ndërkombëtare në referencë të përcaktimeve të tabelës 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi, të përcaktuar si kriter pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë në atë institucion; b) Listën e subjekteve të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testimet ndërkombëtare",-bëhet me dije në udhëzimin e MASR. Sakaq, studentët e regjistruar në ciklin e dytë apo të tretë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë, të cilët nuk i janë nënshtruar testimit të gjuhës angleze, si dhe nuk kanë paraqitur dokumentacion pranë institucioneve të arsimit të lartë duhet të kryejnë testimin sipas këtij udhëzimi.



**KRITERI**
Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloret e tyre nivelin e gjuhës, që do të jetë kriter hyrës në programet e studimit të ofruara prej tyre në ciklin e dytë. Për pranimin në programin e studimeve të ciklit të tretë, kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, të nivelit C1.

**UDHEZIMI**

| Niveli | B1 | B2 | C1 |
|---|---|---|---|
| *Gjuha angleze* | | | |
| Cambridge | PET | FCE | CAE |
| IELTS | 4.0 / 5.0 | 5.5 / 6.0 | 6.5 / 7.0 |
| TOEFL Internet-based Test (iBT) | 57/86 | 87/109 | 110/120 |
| TOEFL Paper-based Test (ITP) | 460 | 543 | 627 |
| TOEIC | 381 / 649 | 650/ 785 | 786 / 935 |
| GESE | - | 7, 8, 9 | 10, 11 |
| APTIS | Aptis B1 | Aptis B2 | Aptis C |
| *Gjuha gjermane* | | | |
| Goethe-Institut, Goethe Zentrum | Goethe-Zertifikat B1 | Goethe-Zertifikat B2 | Goethe-Zertifikat C1 |
| TestDaF | - | TDN 3 - TDN4 | TDN 5 |
| OSD | OSD-Zertifikat B1 | OSD-Zertifikat B2 | OSD-Zertifikat C1 |
| *Gjuha franceze* | | | |
| TFI | 345/604 | 605/824 | 825 |
| DELF | DELFB1 | DELFB2 | DALFC1 |
| TCF | TCF 300 - 399 | TCF 400 - 499 | TCF 500 - 599 |
| TEF | TEF 361-540 | TEF 541-698 | TEF 699-833 |
| *Gjuha italiane* | | | |
| Peruggia | CELI2 livello2 | CELI3 livello3 | CELI4 livello4 |
| Sienna | CILS uno B1 | CILS 2 | CILS 3 |
| PLIDA | PLIDA certification B1 | PLIDA certification B2 | PLIDA certification C1 |
| *Gjuha spanjolle* | | | |
| DELE | DELE inicial | DELE intermedio | DELE superior |

### Artistët shprehin ndjenjat nëpërmjet vargjeve

# Ja këngët që janë dedikim për një histori dashurie

## "Dashuria i jep kuptim jetës"

Egla Xhemali





Tashmë janë bërë të modës dedikimet nëpërmjet këngëve të dashurisë. Artistët vendosin të shprehin ndjenjat duke i shkrirë ato njësh me tekstet dhe tingujt.
Nuk kanë qenë të paktë ata që u kanë kushtuar këngë partnereve të tyre. Është bërë më se normale, gjithashtu, që pas ndarjes së çifteve të vijë një këngë për të përmbyllur etapën e lumtur që kanë kaluar partnerët së bashku.

"Mu ma le fajin" kënga e Mimoza Shkodrës u diskutua për një kohë të gjatë në median rozë duke qenë se erdhi fill pas përfundimit të lidhjes së dashurisë me Seldi Qalliun. Asokohe asnjëri pret tyre nuk kishte pohuar lajmin se ishin ndarë. Bukuroshja që duket se e vuajti shumë këtë "thyerje" zemre vendosi që t'i dedikonte një këngë Qalliut. Fjalët prekëse që jo rrallë herë të rrëqethin kanë bërë që kënga të dëgjohet shumë. Një lamtumirë me fjalë shpirti që është rrënjosur thellë në shpirtin e Mimozës.

Pas prezantimit te "Kënga magjike" të "Plas", u ngritën dyshimet se kënga mund të jetë një dedikim i kantautorit Flori Mumajesi për një lidhje të tij dashurie që nuk pati fundin e lumtur. Në fakt, vargjet i dedikohen Elvana Gjatës për shkak se përkojnë me një deklaratë që këngëtarja ka dhënë para disa muajsh, por Flori me anë të një postimi komunikoi drejtpërdrejt me fansat e tij në "Instagram", duke theksuar se kjo është kënga e të gjithëve. "Kjo këngë nuk është vetëm kënga ime. Është kënga e të gjithë atyre që kanë dashuruar dhe dashurojnë vërtetë. Dashuria i jep kuptim jetës", - shkruan këngëtari. Kënga përcjell një mori emocionesh ndaj dhe është pëlqyer mjaft nga publiku. "Plas" e Mumajesit bëri shumë bujë duke rrëmbyer çmimin e parë në 20-vjetorin e festivalit "Kënga magjike".

Ditën e dasmës së tyre ajo vendosi t'i tregonte edhe një herë se sa shumë e donte përmes muzikës. Xhensila Myrtezaj i dedikoi Bes Kallakut "Çelësin e zemrës". Kënga që u publikua si fillimi me pamje nga dasma e artistëve u bë pjesë e çdo dite të lumtur për çiftet. Pasi kaloi një farë kohë nën atmosferën e festave të fundvitit ata u bënë personazhe të videoklipit më të veçantë që kishin xhiruar ndonjëherë. Fjalë të ngrohta, premtime dhe emocione sjell himni i tyre i dashurisë. Surprizat nuk kishin të mbaruar. Edhe Besi kishte menduar ta gëzonte Xhensilën duke kënduar për të "Skifterja e zemrës". Miqtë dhe familjarët e çiftit janë mrekulluar nga përkimi magjik.

Diva e muzikës shqiptare Aurela Gaçe ia ka dalë gjithmonë të rrëmbejë zemrat e publikut me këngët e saj. Produksioni më i dashur për të dhe jo vetëm, mban titullin "Shpirt i shpirtit tim". Një konglomerat ndjenjash që u bë refren i tejçimit të adhurimit dhe dashurisë për personin e zemrës. Aurela zgjodhi të vijë thjeshtë në klip. Bardhë e zi që nënkupton një mori ngjyrash dhe emocionesh. Të flasësh me gjuhën dhe fuqinë që të dikton shpirti.





# Oriola Marashi braktis Shqipërinë, mësoni ku ka vendosur të jetojë

Oriola Marashi është padyshim një ndër modelet më të komentuara të showbizit shqiptar.

Me format bombastike dhe pozat provokuese, Oriola di se si të qëndrojë gjithmonë në qendër të vëmendjes.

Së fundmi, nëpërmjet një videoje të publikuar në 'Instastory', modelja ka treguar në 'Instastory' se e ka lënë këto ditë Shqipërinë për një projekt në Zvicër.




Teksa po presim bashkëpunimin e saj me labelin OTR, në të cilin Oriola është bërë pjesë, ajo ka filmuar ambientin e një studioje fotografike.

Sido që të jetë mund të themi se e presim me padurim të shohin projektin e ri të modeles.

# Kur do flasim? Alban Ramosaj bën publik numrin e telefonit

Këngëtari i njohur shqiptar Alban Ramosaj ka shpërndarë numrin personal të telefonit në profilin e tij në 'Instagram'.

Pas kërkesës së një ndjekëseje e cila i ishte përgjigjur pyetjes së Albanit "kur do flasim" në 'Instastory', këngëtari u tregua shumë i hapur për t'ia plotësuar dëshirën. Ai bëri publik numrin e tij aktual që mund t'ju duket disi i çuditshëm. Aktualisht Albani ndodhet në Indonezi dhe nuk e dimë sa do të komunikonte me fansat që do ta telefononin çdo minutë teksa po shijon pushimet atje, e megjithatë mund ta provoni njëherë.






# Klaudia Pepa gjen princin, ja si reagon Albi Nako

Së fundmi, Klaudia i ka bërë të gjithë kuriozë me një foto të publikuar në Instagram, ku shfaqet nën shoqërinë e një mashkulli tepër seksi.

Pak ditë pasi deklaroi në një intervistë se ende nuk e ka gjetur dashurinë, balerina e njohur shqiptare bëri një dedikim të veçantë për kolegun e saj dhe një prej talenteve të Amici-t, Francesco Mariottini."Princi im", shkruante Klaudia në një foto ku shfaqet e ngritur në ajër nga Francesco gjatë një kërcimi.

Por balerina nuk ka ndaluar këtu, ajo ka postuar sërish një video teksa bën prova me balerinin.

Ajo që na bëri shumë përshtypje ishte se në kë video, ka qenë pikërisht ish-bashkëshorti i Klaudias dhe koreografi Albi Nako, i cili i ka dhënë like.




Nuk e dimë nëse kjo është një shenjë xhelozie, apo thjesht një pëlqim si një mik, ashtu si Klaudia dhe Albi shprehen në media.




# Zbulohet e vërteta! Fifi sqaron momentet intime me Florin

Më në fund protagonisjta e videos që bëri xhiron e rrjetit, na ka shuar kuriozitetin dhe na ka treguar të gjitha detajet.



Po flasim pikërisht për Fifin dhe videon e saj me Florin që 'çuditi' rrjetin dhe na la disi konfuz të gjithëve.

Fifi ka sqaruar më në fund se çfarë fshihet pas videos provokuese që u publikua në media. Këngëtarja është shprehur se videoja ka qenë ide për klipin e këngës "Ja ke bo vetes". As Flori dhe as Fifi nuk e kuptuan sesi doli online kjo video, por këngëtarja tha se është më mirë që ndodhi kështu.



"Në fakt, ajo video është bërë në tetor të 2017 dhe ka dalë në fund të nëntorit të 2018. Nuk e morëm vesh fare si ka dalë, por shyqyr që ka dalë se kështu duan shqiptarët. Ajo video ka qenë ide për klipin e këngës "Ja ke bo vetes". Mua më erdhi të interpretoja dhe u bë video", u shpreh Fifi.

Aktualisht kënga "Ja ke bo vetes", nuk ka një klip zyrtar. Flori dhe Bruno sqaruan pak kohë më parë se për shkak se kënga kishte qarkulluar para se të dilte në YouTube, ata u detyruan ta publikojnë para kohe pa klip.

### Hashim Thaçi: E padrejtë, serbët sot lëvizin lirisht

# Presidenti i Kosovës: S'duhet marrë në pyetje e Lushtaku, në 1999 masakruan të pafajshëm

Kreu i Kosovës Hashim Thaçi, përmes një statusi në llogarinë personale ka mbajtur një qëndrim mbi intervistimin e Sami Lushtakut nga Prokurori i Specializuar në Hagë. Ai e quan të padrejtë marrjen në pyetje të një çlirimtari siç është Lushtaku dhe nga ana tjetër, shtoi Thaçi, përgjegjësit kryesorë të krimeve të luftës në Kosovë shëtisin të lirë në Serbi dhe në të gjithë botën.

**Postimi i plotë i Thaçit në 'Facebook':**

Sot në Hagë po intervistohet bashkëluftëtari ynë Sami Lushtaku, që vjen nga rajoni i Drenicës ku forcat serbe masakruan me qindra civilë të pafajshëm dhe drejtësia ndërkombëtare as që është marrë me krimet e tyre. Në fshatrat Likoshan e Çirez të Drenicës, më 28 shkurt 1998, forcat serbe vranë dhe masakruan 24 civilë të pafajshëm. Në Prekaz, më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, forcat serbe vranë dhe masakruan 56 anëtarë të



familjes Jashari. Më 26 shtator 1998, në Abri të Epërme të Drenicës, forcat serbe masakruan 23 anëtarë të familjes Deliu. Më 28 mars 1999, forcat serbe në fshatin Izbicë vranë dhe masakruan mizorisht 147 shqiptarë të pafajshëm. Më 5 prill 1999, në fshatin Rezallë, ushtria dhe policia serbe vranë 98 civilë, banorë të Rezallës dhe fshatrave përreth, nga të cilët 44 ishin të zhdukur. Po në muajin prill të vitit 1999, forcat serbe vranë dhe masakruan edhe 54 civilë në Poklek të Ri dhe 24 civilë të tjerë në Çikatovë të Vjetër. Forcat policore dhe ushtarake serbe vranë dhe masakruan edhe qindra civilë të tjerë të pafajshëm anekënd Drenicës dhe Kosovës, por drejtësia ndërkombëtare as që ka nisur të merret me këto krime. Sot, padrejtësisht po intervistohet një çlirimtar në Hagë, kurse kriminelët serbë vazhdojnë të shëtisin lirshëm në Serbi dhe botë. Ndaj çlirimtarëve tanë, në emër të drejtësisë ndërkombëtare po bëhet padrejtësia më e madhe.

### Zëvendëskryeministri i Kosovës: Qeveria s'mund të refuzojë kërkesën e SHBA

# Pacolli kundër Haradinajt: Të hiqet taksa ndaj Serbisë

## *"Të bëjmë disa kompromise në kuadër të demarkacionit me serbët"*

Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli është shprehur kundër qëndrimit të kryeministrit Ramush Haradinaj, ndërsa ka kërkuar heqjen e taksës ndaj Serbisë. Sipas Pacollit, qeveria kosovare nuk mund të refuzojë kërkesën e SHBA-së për heqjen e taksës për mallrat nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Në një intervistë për televizionin publik të Kosovës, Pacolli tha se do të bisedojë me Haradinajn për mundësinë e përgjigjes pozitive ndaj SHBA-së. Mes të tjerash ai tha në dialogun me Serbinë, Kosova mund të bëjë disa kompromise, të cilat, sipas tij, "do të ndodhin në kuadër të demarkacionit me Serbinë". Ndërkaq kujtojmë se ditën e hënë Këshilli i Sigurisë Kombëtare në SHBA dhe Departamenti i Shtetit Amerikan kanë formësuar pozicionin e tyre lidhur me zhvillimet aktuale në Kosovë, respektivisht çështjen e taksës së vendosur nga qeveria dhe dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Mediat kosovare kanë zbuluar mesazhin e qartë i cili tashmë iu është transmetuar në formë të shkruar autoriteteve shtetërore kosovare. Ky qëndrim i prerë i administratës amerikane ndaj Kosovës është përmbledhur në tetë pika kryesore, të cilat theksojnë se masa e marrë për të vënë taksën, nuk është konsultuar me SHBA. "Masat tarifore janë marrë pa asnjë konsultim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës". "Shprehim zhgënjimin e thellë që pas letrës së Presidentit Trump drejtuar Presidentit Thaçi, jo vetëm që nuk ka pasur reflektim pozitiv nga ana e qeverisë së Kosovës, por janë shtuar produktet, të cilat i nënshtrohen tarifës". "Kërkojmë pezullimin e menjëhershëm të tarifës. E njëjta tarifë mund të rivendoset në rast se dështon marrëveshja me Serbinë". "Mbështetja e SHBA-ve për Kosovën nuk është e pakushtëzuar. Kosova për momentin e bart barrën e rrezikimit të dështimit të dialogut". "Nëse tarifa nuk suspendohet urgjentisht, SHBA-të do të suspendojnë asistencën në fushën e sigurisë, pra mbështetjen për FSK". "Suksesi dhe



Zëvendëskryeministri i Kosovës, Behgjet Pacolli

arritja e marrëveshjes nuk ndërlidhen me rolin e znj. Federica Mogherini dhe BE-në. Arritja e marrëveshjes është interes strategjik i SHBA-ve, prandaj është e papranueshme për ne vënia në pikëpyetje e këtij qëllimi strategjik nga ana e veprimeve të papërgjegjshme të liderëve kosovarë". "Në rast se marrëveshja dështon për shkak të Kosovës, barrën e përgjegjësisë dhe pasojat do t'i bartë vetë Kosova dhe individët përgjegjës për këtë dështim". "Kosova me sjelljet e saja të papërgjegjshme po e rrezikon seriozisht miqësinë me SHBA-të". Klan Kosova, gjithashtu, e ka të konfirmuar që me kërkesë të Shtëpisë së Bardhë, ky mesazh është përcjellë tek pesë institucionet të rëndësishme shtetërore të Kosovës nëpërmjet kanaleve diplomatike. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se fundmi se nëse Serbia e "zvarrit" arritjen e një marrëveshje me Kosovën deri në vitin 2022, vit ky kur Serbia synon të hyjë në BE, atëherë taksa do të qëndrojë deri në atë vit në fuqi, raporton zëri. "Nuk është qëllimi ynë që me taksën të bllokojmë dialogun. Serbia e ka për qëllim që ta zvarritë procesin e dialogut me Kosovën deri në vitin 2022, sepse atëherë pretendon të hyjë në BE e ne do ta mbajmë taksën deri më 2022, nëse s'ka marrëveshje deri atëherë taksa qëndron", tha Haradinaj. Ndërkohë i pyetur nëse ka marrë një "ultimatum" nga ana e SHBA-ve për heqjen e taksës për produktet serbe, Haradinaj ka thënë se përmes ambasadorit të SHBA-ve i është kërkuar kjo gjë. "Qëndrimi i Departamentit të Shtetit Amerikan tek qeveria e Kosovës vjen përmes ambasadorit të SHBA-ve, ambasadori ka shprehur qëndrimin për pezullimin e taksës, është qëndrim i tyre. Po, ky është qëndrim i tyre", theksoi Haradinaj pas mbledhjes së qeverisë. I pyetur nëse ka "zbutur" qëndrimet e tij për heqje të taksës ai tha se "sikur të kishim sot një kontratë do ta kishim pezulluar këtë taksë për të mos e vazhduar këtë 'cirk' që po quhet dialog".

## Votimi për marrëveshjen e Prespës, një moment i rëndësishëm për Alexis Tsipras



Mbrëmja e djeshme ishte shumë e rëndësishme për kryeministrin grek, Aleksis Cipras. Qeveria iu nënshtrua mocionit të votëbesimit të kërkuar prej tij, pas largimit të dielën nga koalicioni të aleatëve kryesorë, Grekëve të Pavarur. Nëse arrin t'i mbijetojë mocionit, Cipras do ta ketë të lehtë të marrë miratimin në parlament edhe të marrëveshjes së Prespës për emrin e ri të Maqedonisë, që ai e konsideron si arritjen më të madhe të kabinetit të tij pas nxjerrjes së vendit nga kriza ekonomike. Qeveria pritet ta fitojë mocionin e mosbesimit me 151 vota, pas mbështetjes publike që mori nga 6 deputetë të forcave të tjera politike, 4 prej të cilëve nga partia Grekët e Pavarur, të cilët u përjashtuan nga partia. Ndërsa Marrëveshja e Prespës pritet të votohet para datës 20 janar. Burime pranë parlamentit grek thanë për Tv Klan se qeveria planifikon ta kalojë atë në komisione të enjten dhe më pas ta çojë për të premten, apo të shtunën. Ky skenar pritet të përballet me jo pak kundërshti, pasi procedurat parlamentare nuk mund të reduktohen në mënyrë kaq drastike. Gjithsesi, burimet qeveritare thanë se synimi i Kryeministrit është që edhe disa çështje të tjera të kryhen me procedura të përshpejtuar, përfshirë edhe riformatimin e kabinetit qeveritar pas largimit të partisë së Kamenosit.

### SHKURT

#### 'Sherri' më Thaçin, flet Daçiç: Na akuzonin për genocide

Vetëm një ditë pasi presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç tregoi për tentativën e përplasjes fizike me presidentin e Kosovës në Bruksel Hashim Thaçin, ministri i jashtëm i Serbisë, Ivica Daçiç, i cili ishte, gjithashtu, pjesëmarrës nga pala serbe ka treguar detaje. "U mërzita dhe u thashë gjithçka. Edhe ata filluan të na akuzonin për genocid dhe se jemi vrasës serb. Në atë moment ne u ngritëm mbi tavolinë dhe iu sulëm. Të gjithë të pranishmit e tjerë u larguan deri sa ndërhynë për të na ndarë"- ka thënë Daçiç. Një ditë më parë, Vuçiç u shpreh se të dy politikanët kanë qenë afër një përplasjeje fizike, por e gjithë kjo situatë ka kaluar shpejt. "Njëherë ishim afër përleshjes fizike. Hajredin Kuçi iu sul Ivica Daçiçit, ndërsa unë atij, por gjithçka përfundoi shpejt"- shtoi Vuçiç.

#### Presidenti serb: Flas çdo gjë me Putin, kërkoj këshilla nga ai

Presidenti serb Aleksandër Vuçiç ka deklaruar se konsultohet shpesh me udhëheqësin rus Vladimir Putin për çështje të ndryshme dhe madje "kërkon" këshilla nga ai. Të dy ata pritet të takohen në Beograd të enjten. Politikani serb tha se ai e informon Putinin për "çfarë po ndodh" dhe kurrë nuk e gënjen gjatë takimeve të tyre. Në një intervistë me agjencinë e lajmeve 'TASS', Vuçiç rrëfeu se i thotë Presidentit rus të vërtetën edhe kur atij nuk i pëlqejnë gjërat që ai thotë." Dhe unë besoj se është një nga gjërat që Putini respekton shumë", u shpreh ai. Rusia dhe Serbia tradicionalisht gëzojnë marrëdhënie të mira pasi të dyja kombet kanë lidhje të forta historike dhe kulturore. Aleksandar Vuçiç shpjegoi se është e rëndësishme për atë që Putin ta trajtojë Serbinë si një partner të barabartë. "Ai është një udhëheqës i një vendi të madh, ndërsa unë jam një udhëheqës i një vendi të vogël dhe ai respekton një vend të tillë, për të cilin unë jam përgjithmonë mirënjohës". Presidenti, gjithashtu, theksoi se Putin "respekton" pavarësinë e vendit ballkanik. Ai e kupton se (Serbia) i është nënshtruar presionit ndërkombëtar për t'u larguar nga Rusia, për t'u bashkuar me NATO dhe për të marrë pjesë në fushata të ndryshme kundër Rusisë. Por Serbia nuk ka bërë asnjë nga këto.

## Rusia akuzon Amerikën: Po destabilizon Ballkanin

# Putin kundër ndryshimit të emrit të Maqedonisë: Rishikohet identiteti ndërkombëtar

Vladimir Putin, presidenti rus akuzon SHBA-në se po shndërrohen në faktor destabilizues në Ballkan. Në një intervistë për të përditshmet serbe Novosti dhe Politika, të publikuar një ditë para vizitës në Beograd, Putin shprehet se Uashingtoni po u imponon vendeve të rajonit anëtarësimin në NATO për të garantuar influencën mbi ta. "Në 2008-ën Uashingtoni mbështeti pavarësinë e Kosovës, të shpallur në mënyrë të jashtëligjshme në 1999-ën. Në 2017-ën, Mali i Zi u bë pjesë e NATO-s pavarësisht se gjysma e popullit ishte kundër. Vitin e kaluar nisën procedurat e anëtarësimit me forcë të Maqedonisë në NATO, duke shfrytëzuar procedurën për ndryshimin e emrit që, në fakt, rishikon identiteti kombëtar të maqedonasve. Votuesit e injoruan procesin duke bërë të dështojë referendumi, por procesi vazhdoi me presion nga jashtë". Shefi i Kremlinit anashkalon megjithatë faktet historike, mbi bazën e të cilave kanë ndodhur këto zhvillime e veçanërisht masakrat e ushtrisë serbe ndaj civilëve, që çuan në Pavarësinë e Kosovës. Në intervistën për të përditshmet serbe, Putin tha se këtë vit Serbia do të anëtarësohet në Unionin Ekonomik Euroaziatik, që e bën pjesë të unionit doganor me disa prej ish-republikave sovjetike. Analistët politik e shohin këtë union si përpjekje të Moskës për të ringjallur Bashkimin Sovjetik për të sfiduar zgjerimin e influencës perëndimore në ishvendet e bllokut komunist.



**VLADIMIR PUTIN:**
"Në 2008-ën Uashingtoni mbështeti pavarësinë e Kosovës, të shpallur në mënyrë të jashtëligjshme në 1999-ën. Në 2017-ën, Mali i Zi u bë pjesë e NATO-s pavarësisht se gjysma e popullit ishte kundër. Vitin e kaluar nisën procedurat e anëtarësimit me forcë të Maqedonisë në NATO, duke shfrytëzuar procedurën për ndryshimin e emrit që, në fakt, rishikon identiteti kombëtar të maqedonasve. Votuesit e injoruan procesin duke bërë të dështojë referendumi, por procesi vazhdoi me presion nga jashtë", ka thënë Putin.

## Negociatori i Bashkimit Europian: Është i nevojshëm ratifikimi i marrëveshjes

# S'ka Brexit, një derë e hapur për Britaninë në BE

## KE: Kryeministrja të heqë dorë nga vijat e kuqe

Negociatori i Bashkimit Europian për Brexit i hapi derën Mbretërisë së Bashkuar për të rihapur bisedimet për të ardhmen e marrëdhënieve mes BE-së dhe Britanisë, nëse Theresa May heq dorë disa prej 'vijave të kuqe' të negociatave të saj. Duke folur mëngjesin e të mërkurës, pasi deputetët britanikë refuzuan marrëveshjen e Kryeministres, Michel Barnier tha se në mënyrë unanime, Këshilli Europian ka rënë dakord që, nëse Britania heq dorë nga vijat e kuqe dhe nëse e bën këtë zgjedhje edhe më ambicioze dhe shkon përtej një marrëveshjeje të thjeshtë tregtie, atëherë Bashkimi Europian do të jetë gati për t'i dhënë një përgjigje të favorshme. May tha se ajo dëshiron që t'i japë fund lëvizjes së lirë, të tërhiqet nga bashkimi doganor, tregtia e përbashkët dhe jurisdiksioni i Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Sipas asaj që shkruan e përditshmja britanike "The Independent", Barnier sugjeroi se nuk mund të ketë rinegocim për marrëveshjen aktuale, që u refuzua nga deputetët britanikë. Por ndryshimet e negociatave mund t'i japin një mundësi Kryeministres britanike, për të marrë votën e deputetëve, përfshirë atyre laburistë, të cilët kërkojnë të mbajnë bashkimin e doganave dhe marrëdhënie të ngushta me tregun e përbashkët. "Çfarëdolloj gjëje të ndodhë, është i nevojshëm ratifikimi i kësaj marrëveshjeje", tha Barnier përpara deputetëve të Parlamentit Europian. "Është një parakusht për të krijuar besim të ndërsjellë, teksa presim për raundin e dytë të negociatave që do të nisin sa më parë të jetë e mundur". Ndërsa zëvendëspresidenti i Komisionit Europian, Frans Timmermans tha se askush nuk duhet të krijojë iluzione, "Brexit dëmton. Dëmton Mbretërinë e Bashkuar dhe dëmton edhe Bashkimin Europian". Duke cituar shkrimtarin britanik CS Lewis, ai la të kuptohej se ekziston mundësia që Britania të qëndrojë në bllok: "Ne nuk mund të kthehemi pas dhe të ndryshojmë fillimin, por mund ta nisim ku jemi dhe të ndryshojmë fundin". Nuk kishte shumë dyshime se marrëveshja e Theresa May me Brukselin nuk do të votohej në parlamentin britanik. Dhe ndodhi pikërisht kështu. Ndërkaq vetëm dy ditë më parë vetëm 202 deputetë e mbështetën marrëveshjen, ndërsa kundër votuan 432 të tjerë. Me votat kundër marrëveshjes u bashkua 1/3-ta e deputetëve partisë së kryeministres May, çka nga analistët konsiderohet si rebelimi më i madh i konservatorëve në histori. Pas shpalljes së rezultatit, May shprehu qëndrimin e saj kundër një referendumi të dytë. Theresa May, kryeministre e Britanisë së Madhe: Është e qartë që dhoma e ulët nuk e pranoi këtë marrëveshje, por sot ky votim nuk na thotë asgjë se çfarë mbështet. Për ata që kanë frikë se strategjia e qeverisë është që të pengojë daljen më 29 mars, dua t'u them se gabohen, por çdo ditë që kalon pa këtë marrëveshje do të thotë më shumë paqartësi e mllef. Lideri i laburistëve në opozitë Jeremy Corbyn njoftoi se kishte dorëzuar në parlament kërkesën për mocion mosbesimi kundër qeverisë. Jeremy Corbyn, Kryetar i Laburistëve Britanikë: Kjo është një humbje katastrofike për këtë qeveri. Faji është i kryeministres që këmbënguli për këtë marrëveshje edhe pse ajo u refuzua gjerësisht nga parlamenti. Ajo i mbylli derën dialogut. Dalja pa marrëveshje nga unioni duhet të përjashtohet si mundësi. Ndaj dhe kam paraqitur një mocion mosbesimi për qeverinë. Diskutimi i mocionit do të nisë të mërkurën. Nëse qeveria nuk mbijeton, vendi mund të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Dy janë zgjidhjet më të mundshme, dalja pa marrëveshje ose një referendum i dytë që mund ta anulojë Brexitin. Tashmë mbeten edhe rreth 70 ditë nga afati përfundimtar i daljes së Britanisë nga BE.



Kryeministrja e Britanisë në parlament

**DEPUTETI I BE:**
"Çfarëdolloj gjëje të ndodhë, është i nevojshëm ratifikimi i kësaj marrëveshjeje. Është një parakusht për të krijuar besim të ndërsjellë, teksa presim për raundin e dytë të negociatave që do të nisin sa më parë të jetë e mundur", tha Barnier.

## SHBA, FENOMENI NATYROR QË MAHNIT NJERËZIT KUDO NË BOTË




Një fenomen magjepsës natyror ka bërë që njerëzve të ndryshëm t'u duket herë si anije kozmike aliene, herë si një karosel e herë si Hëna. Disqet e akullit krijohen në kthesat e lumenjve ku uji që vjen me rrjedhë krijon një forcë që konsumon qoshet e akullit duke e rrotulluar.

SHKURT

### Zhduket studenti, ja gjithçka që la pas

Një ngjarje misterioze, e mbushur me dyshime dhe të panjohura, është ajo që rrethon zhdukjen e një 20-vjeçari nga Turkmenistani. I riu, i cili studionte në një universitet në Stamboll, ka ngritur një çadër kampingu në kanionin e Samsunit në Turqi dhe iu ka dërguar një video disa të afërmve dhe më pas është zhdukur. "Studioj në shkollën më të mirë, kam para dhe të gjitha mundësinë. Kaq është mjaftueshëm të jetosh. Nëse më gjeni, mos i fajësoni njerëzit e zonës", thuhet në videon e fundit që i riu Yusuf Hojayev u dërgoi të hënën disa miqve. Me të parë videon, një prej kushërinjve të tij të parë është nisur menjëherë për në Samsun, teksa në vendin ku besohet se po qëndronte i riu ka gjetur vetëm xhupin e tij me të cilin kishte mbështjellë një pemë në majën e malit, çantën dhe ca para. Forcat e kërkim shpëtimit dhe ekipet e xhandarmërisë nuk kanë arritur të gjejnë asnjë shenjë nga turkmeni rreth e rrotull në zonë. Një operacion i gjerë kërkimi ka nisur për të riun në male dhe në ujë.

### Ulet tensioni me Phenianin, Koreja e Veriut jo më 'armik'

Koreja e Jugut ka hequr referencën për Korenë e Veriut si një vend "armik", në një dokument të ushtrisë, duke reflektuar kështu nismën e Presidentit Moon Jae-in për uljen e tensionit me Phenianin. Ministria e Mbrojtjes e Koresë së Jugut e cilësonte Korenë e Veriut si armike që nga koha e një dokumenti politik të vitit 2010, pas vrasjes së 50 koreano-jugorëve në dy sulme të veçanta: në një ishull dhe në një anije të marinës koreanojugore. Për të dyja këto sulme u fajësua Pheniani. Heqja e epitetit "armik" në dokumentin që u publikua të martën, pritet të shkaktojë zemërim në mesin e konservatorëve në Korenë e Jugut, të cilët thonë se përpjekjet e Presidentit Moon për ndërtimin e marrëdhënieve më të mira me regjimin e Kim Jong Unit, po minojnë mbrojtjen e Koresë së Veriut. Fjalimi i Vitit të Ri më 2017 i udhëheqësit koranoverior, ku ai ofroi dërgimin e një kontingjenti atletësh koreanoveriorë në Lojërat Olimpike të Pjong-çangut në Korenë e Jugut, u pasua me disa përpjekje të mëdha diplomatike, siç ishin tre takime me udhëheqësin koreanojugor, Presidentin Moon.

INTERVISTA

# DIANA ÇULI:
# Tri gra në kryeministri dhe një komplot ballkanik

*Një rrëfim për romanin "Një vrasje në kryeministri"*

*Shkrimtarja: E dëshiroj ditën kur një grua të jetë kryeministre*

Fatmira Nikolli

Subjekti i këtij libri zhvillohet nëpër Ballkan, të cilin unë kam patur mundësinë ta njoh mirë, për shkak të veprimtarive të mija letrare e të shoqërisë civile. Ishte një mundësi që më jepte një skenë letrare të përkryer për idenë time. Çdo qytet e rrugë që kam përshkruar aty i kam njohur nga afër, ashtu si edhe njerëz të këtyre vendeve, tipare të të cilëve më kanë shërbyer pastaj për të krijuar personazhet e ndryshme".

Një kryeministre, një detektive dhe shumë mistere. Libri fillon me një punonjës të lartë të kryeministrisë, i cili gjendet i vdekur në zyrën e tij, vonë natën. Dyshohet se mund të jetë edhe vrasje. Nëse është e vërtetë, kush e ka kryer vrasjen? Dhe përse? Kjo është historia e romanit më të ri nga shkrimtarja Diana Çuli. Pas romanit "Hoteli i drunjtë" apo "Rrethi i kujtesës" shkrimtarja i rikthehet thrillerit sërish.

Në një intervistë për "GAZETA SHQIPTARE" Çuli rrëfen romanin dhe mënyrën si ai erdhi, personazhet dhe udhëtimin e tij në Ballkan. "Unë besoj tek letërsia, që më thotë: po sikur? Po sikur të ketë një gjë të tillë, çfarë mund të ndodhë? Gjithashtu, në historinë e njerëzimit asgjë nuk përjashtohet. Njerëzit çfarë nuk kanë bërë e çfarë nuk bëjnë për të arritur synimet e tyre. Krijojnë grupe, parti, po edhe sekte të fshehta, urdhra të fshehtë, organizata ligjore e jo ligjore; i kanë bërë në të shkuarën, i bëjnë dhe sot e kësaj dite", thotë Çuli, duke shtuar se vrasjet politike, veçanërisht të tipit që unë kam përshkruar në libër kanë shumë shembuj e zanafilla; janë të njohura vrasjet politike të disa organizatave anarkiste, vrasjet politike jo shumë larg nesh, në Itali, vite më parë, vrasjet mafioze, po shumicën e rasteve të lidhura me politikën e kështu me radhë.

**- Titulli i romanit tuaj më të ri "Një vrasje në kryeministri" grish ende pa e marrë në duar, prej faktit se është kryeministria "si vendi i pushtetit" që vihet në fokus. A erdhi natyrshëm apo e zgjodhët me qëllim këtë titull?**

Janë të dyja arsyet për këtë titull. Erdhi natyrshëm, sepse libri fillon me një punonjës të lartë të kryeministrisë, i cili gjendet i vdekur në zyrën e tij, vonë natën. Dyshohet se mund të jetë edhe vrasje. Nëse është e vërtetë, kush e ka kryer vrasjen? Dhe përse? Pra, në këtë pikëpamje titulli ishte i natyrshëm. Nga ana tjetër mua më dukej jo shumë origjinal, sepse ka shumë vepra thriller që kanë tituj të ngjashëm: vrasje këtu ose atje. Por, pasi u këshillova edhe me botuesen, Arlinda Dudajn, vendosëm që ky titull edhe ishte i natyrshëm, edhe mund të tërhiqte lexuesin me përmbajtjen e tij. Pra, edhe ajo që thoni ju, se të grish "vendi i pushtetit" është pak a shumë e vërtetë.

**- Një thriller politik. Keni thënë se përvoja juaj politike ju ka ndihmuar për ta shkruar. Si konkretisht ?**

Nuk kam ndonjë përvojë shumë të gjatë në politikë; por kam qenë një mandat në parlament, shumë vite më parë, që ishte gjithnjë një përvojë mjaft e mirë për të njohur sistemin politik nga brenda dhe jo vetëm nga jashtë, për të kuptuar më mirë si funksionon administrata, raportet me politikën, si sillen njerëzit kur kanë pozitë dhe pushtet në krahasim me ata që nuk e kanë. Përse mund të jenë, pse jo, edhe në rrezik, nëse janë të ndershëm dhe nuk i nënshtrohen presioneve të gjithfarëllojshme - gjë jo e shpeshtë - le ta pranojmë - por letërsia merret me gjithçka, edhe me gjërat e rralla. Për shembull, njohja e jetës politike më ndihmoi ta kisha më të lehtë për të trajtuar marrëdhëniet e pushtetarit me vartësit, për punonjësit midis tyre, dinamikat, heshtjet që flasin, nënkuptimet, enigmat, intrigat...! Kjo njohje më shërbeu të krijoj personazhe, linja subjekti, ngjarje... Aq më tepër që synimi im ishte të shkruaja një thriller që lidhej me politikën. Pra që krimi, le të themi, i cili është dhe një nga bazat e këtyre lloj romaneve, të kishte motive politike.

> Nuk jam e mendimit se sot gratë zgjidhen për t'u komanduar nga burrat. Ka prej tyre që janë me personalitet të fortë. Pak burra ka në politikë që komandohen nga shefat e tyre? Pra, kjo është çështje karakteri, jo burri ose gruaje... gjithnjë sipas mendimit tim.

**- Kemi lexuar më shumë thriller-a të autorëve të huaj. Në Shqipëri pak lëvrohet. Çfarë ju bëri të mendonit për këtë zhanër?**

Po, e vërtetë. Ne e lëvrojmë shumë më pak këtë zhanër, ndërsa në botë, veçanërisht dekadat e fundit ka një prirje mjaft të dukshme. Shumë autorë i trajtojnë temat e subjektet e tyre përmes skemës së thriller-it. Personalisht e kam pëlqyer shumë, që në rininë e hershme. Një roman i imi, "Rrethi i kujtesës", që më vonë u realizua dhe film, është një lloj thriller-i. Një roman i mëparshëm, "Hoteli i drunjtë", është i kësaj kategorie. Elementë të thriller-it kam dhe në libra të tjerë. Megjithatë, "Vrasje në kryeministri" është një realizim më i plotë, sipas meje, se sa librat e mi të mëparshëm me këtë teknikë. Arsyeja pse e zgjodha këtë radhe ishte tema e librit. Doja të shkruaja për krimin politik të organizuar, për grupe njerëzish, oligarkësh, ideologësh, të fiksuarish, që, për interesat e tyre nuk kursejnë individët dhe shoqërinë - gjëra që kanë ndodhur përherë në histori. Në këtë temë thriller-i më ndihmonte shumë që ta mbaja ndezur kureshtjen e lexuesit, i cili, përmes ngjarjeve dhe situatave pezull, të mund të diskutonte me vete ide të ndryshme të politikës e të shoqërisë.

**- Një vrasje në mjediset e kryeministrisë së Shqipërisë çel veprën duke e çuar më pas hetimin nëpër Ballkan. Një komplot ndërkombëtar. A besoni në të tilla ?**

Unë besoj tek letërsia, që më thotë: po sikur? Po sikur të ketë një gjë të tillë, çfarë mund të ndodhë? Gjithashtu, në historinë e njerëzimit asgjë nuk përjashtohet. Njerëzit çfarë nuk kanë bërë e çfarë nuk bëjnë për të arritur synimet e tyre. Krijojnë grupe, parti, po edhe sekte të fshehta, urdhra të fshehtë, organizata ligjore e jo ligjore; i kanë bërë në të shkuarën, i bëjnë dhe sot e kësaj dite. Vrasjet politike, veçanërisht të tipit që unë kam përshkruar në libër kanë shumë shembuj e zanafilla; janë të njohura vrasjet politike të disa organizatave anarkiste, vrasjet politike jo shumë larg nesh, në Itali, vite më parë, vrasjet mafioze, po shumicën e rasteve të lidhura me politikën e kështu me radhë. Për shkrimtarët ky është një terren mjaft "i pasur" për të gërmuar, kërkuar, për t'u bazuar, për të fantazuar, për të krijuar pastaj një botë letrare të filtruar nga ajo realja.

**- Hetimet për vrasjen ju ia besoni një gruaje. Përse e zgjodhët grua? A kishit në mendje një grua të caktuar tek e cila kishit besim, apo se të qenit grua ju ka ndihmuar në procesin e shkrimit të këtij romani?**

Në literaturën botërore të thriller-it, që, siç thamë dhe më sipër, është një prirje e fortë prej shumë kohe, ka mjaft hetuese gra. I shohim edhe në filma, nëse duam të kujtohemi më shpejt. Sot, gratë janë mjaft të pranishme në komisariate, në shërbimet inteligjente, në agjencitë private investiguese. Ky është realiteti. Pra, nuk kam krijuar një figurë të pabesueshme. Mund të mos jetë tipike, por ky nuk është një kusht për letërsinë. Nga ana tjetër, nga pikëpamja artistike, një grua e re, e bukur dhe e zgjuar, që heton një krim pa u pikasur nga të tjerët, është shumë tërheqëse. Nuk kisha në mendje një person të caktuar, sepse kjo do të ishte një grackë që do të ma dështonte personazhin, por kisha në mendje një personazh që mund të ekzistonte edhe në jetë, në një rrethanë të caktuar. A më ka ndihmuar të qenit grua në shkrimin e këtij romani? Nuk besoj se kjo gjë ka ndonjë ndikim të qenësishëm. Beti Duka, investiguesja, ka dhe një vëlla, me të cilin punojnë së bashku, madje ai mban peshën e veprimeve shumë të rrezikshme; ndihmojnë-






njeri tjetrin. Por, ndoshta, ndonjë element, ndonjë ndjesi, ndonjë përvojë që ne gratë e kemi të ndryshme nga burrat, mund ta kem përçuar në libër. Këtë nuk di ta them. Mund ta gjykojë më mirë lexuesi.

**- A ju është dashur të udhëtoni e të hulumtoni për të krijuar skena të caktuara? A ju është dashur të rishihni për shembull kryeministrinë për të gjetur vendngjarjen, ose vendin ku komploti merr jetë?**

Po, këto janë skenat, skelat, trarët, çatia e dyshemeja e librit. Janë bota e tij virtuale, e bazuar në atë reale, ku lëvizin personazhet. Subjekti i këtij libri zhvillohet nëpër Ballkan, të cilin unë kam patur mundësinë ta njoh mirë, për shkak të veprimtarive të mija letrare e të shoqërisë civile. Ishte një mundësi që më jepte një skenë letrare të përkryer për idenë time. Çdo qytet e rrugë që kam përshkruar aty i kam njohur nga afër, ashtu si edhe njerëz të këtyre vendeve, tipare të të cilëve më kanë shërbyer pastaj për të krijuar personazhet e ndryshme. Po edhe mentalitete, qëndrime e ide. Mbi të gjitha, më ka shërbyer për të përforcuar e konfirmuar atë që ndjeja dhe dija, po që e preka nga afër: veçanësinë e mrekullueshme ballkanase, që për fat të keq, popujt e gadishullit shpesh e harrojnë që e zotërojnë.

Për sa i përket mjedisit në kryeministri, aty unë kam hyrë dy ose tri herë në jetën time, e madje, ndoshta vetëm në katin e parë, por kjo nuk do të thotë gjë. Ne jetojmë me atë që ndodh në Shqipëri dhe na duket sikur e njohim çdo mur të ndërtesave ku zhvillohet një pjesë e madhe e vendim-marrjeve. I kam parasysh zyrat, korridoret, shkallët, frymën, ajrin…edhe ju, besoj… edhe lexuesi që do të lexojë këto radhë…Aq më tepër që ngjarja del nga kryeministria e vazhdon në rrugën e madhe… Por, padyshim, kur skicoja e më pas kur shkruaja librin, isha më e vëmendshme për gjithçka që lidhej me konfiguracionin e ndërtesës.

**- Janë tri gra në qendër të romanit tuaj, një prej tyre është kryeministre. A e shihni të largët ditën kur ky parashikim të marrë jetë? Apo ende gratë zgjidhen për t'u komanduar nga burrat ? Se në roman duket sikur burrat janë "kalimtarë"…**

Nuk e di, nuk e parashikoj dot. Por…e dëshiroj që kjo ditë të vijë. Prandaj dhe e kam realizuar dëshirën duke e vënë personazh. Nuk jam e mendimit se sot gratë zgjidhen për t'u komanduar nga burrat. Ka prej tyre që janë me personalitet të fortë. Pak burra ka në politikë që komandohen nga shefat e tyre? Pra, kjo është çështje karakteri, jo burri ose grua-je… gjithnjë sipas mendimit tim. Ndërkohë, them se nuk i kam dhe aq kalimtarë personazhet burra. Si numër ata janë më shumë se sa gratë, sepse në grupin e projektit UNESCO- që bredh nëpër Ballkan dhe ku Beti është pjesë, ajo është e vetmja grua, përveç një tjetre që shfaqet më rrallë, dhe ka si kolegë katër burra, të cilët janë shumë aktivë gjatë gjithë librit. Sepse edhe në administratën tonë vendim-marrëse, ka gra, por përqindja anon nga burrat, Dhe unë kam ruajtur këtë peshore.

**- A ju kanë dalë personazhet "nga duart"? A kanë arritur ata, në një farë mënyre, t'i tejkalojnë pritshmëritë që kishit prej tyre? A ka qenë Diana që i ka udhëhequr, apo ka ndodhur të jenë ato që të tërheqin drejt hapit tjetër?**

Më duket se po. Kjo pyetja juaj më bën të mendohem… Po… Për shembull, një personazh, Igli, më ka dalë nga duart, se e kisha menduar tjetërsoj në fillim. Ai i rezistoi tundimit tim për ta ndryshuar dhe qëndroi kokëshkëmb në të vetën. Ndërsa një personazh tjetër, Igor Rehanoviçi, serb, më ndryshoi shumë gjatë shkrimit, sa nuk e dija më në isha unë që po e drejtoja, apo ai mua. Ky proces është shumë interesant. Le të themi se, në të tilla raste është logjika ajo që fiton betejën dhe jo emocioni, jo lidhja me personazhin, jo ndjesia. Por, me këta personazhe jam lidhur si shumë…aq shumë sa madje më duket se do të vazhdoj t'i ndjek në aventurat e tyre të mëtejshme…të shoh se ku duan të shkojnë…

# IKËN KUMBARO, "ARTURBINËN" E MERR NË MENAXHIM TEATRI KOMBËTAR

Teatri Kombëtar ka bërë me dije se prej datës 10 janar do të ushtrojë rolin e koordinatorit për menaxhimin e kalendarit të aktiviteteve artistike dhe dhënien me qira të sallave/ambienteve në Qendrën Kombëtare Kulturore Skena e Re, "ArTurbina". Lëvizja vjen në kohën kur ministrja Mirela Kumbaro është shkarkuar dhe në krye të Ministrisë së Kulturës vjen Elva Margariti. Deri më tani, që prej inaugurimit të "ArTurbinës" institucioni është menaxhuar nga Ministria e Kulturës. Vendimi për t'ia kaluar TK mund të lexohet edhe si zhvendosje e Teatrit Kombëtar aty- duke lënë të paqartë pozicionin e Teatrit Kombëtar Eksperimental.



TK njofton se të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë duke filluar nga dita e sotme deri në 31 janar 2019, për periudhën shkurt- qershor 2019 sipas formatit të mëposhtëm:

Aplikimi për marrje me qira të ambienteve

Të gjitha Institucionet/subjektet që kërkojnë të përdorin ambientet e godinës ArTurbina duhet të:

1. Bëjnë një kërkesë zyrtare pranë Teatrit Kombëtar ose të dërgojnë një e-mail zyrtar në adresën: info@teatrikombetar.gov.al

2. Në shkresë ose e-mail duhet të përshkruhet:

a. Subjekti që kërkon të zhvillojë aktivitetin

b. Aktiviteti për të cilën kërkohet përdorimi i ambientit te ArTurbinës (përshkrimi dhe programi aktivitetit).

c. Ambienti që kërkohet me qira

d. Datat e zhvillimit të aktivitetit.

e. Orari i zhvillimit të aktivitetit.

f. Të dhëna nëse aktiviteti është projekt i financuar apo mbështetur nga Ministria e Kulturës.

g. Të dhëna të tjera të rëndësishme

Në fund shënohet se "prioritet në kalendarin artistik tek Skena e Re ArTurbina do të kenë produksionet e Teatrit Kombëtar, Institucionet e tjera publike të artit dhe kulturës si dhe aktivitet teatrore të skenës së pavarur".

# BOTOHET NË ITALI ROMANI "RRËFENJË ME NDËRKOMBËTARË" I SHKRIMTARIT YLLJET ALIÇKA

Sapo ka dalë nga shtypi në italisht romani "Rrëfenjë me ndërkombëtarë" i shkrimtarit Ylljet Aliçka, botuar nga shtëpia botuese "Rubbettino" me përkthim të Elio Mirakos dhe Amik Kasaruhos.

Në prezantimin e daljes së librit botuesi shkruan: "Diplomatët në karierë-Një komedi e hidhur dhe një ironi thumbuese". Selia e një përfaqësie diplomatike ndërkombëtare në Shqipëri, menjëherë pas rënies së komunizmit; një ambasador i dëshpëruar, për shkak të tradhtisë së të dashurës së tij të re; disa atashé, me kombësi të ndryshme, që bëjnë luftë bërrylash cili të dalë në krye dhe një, nëpunës i ri shqiptar, që vëzhgon paternalizmat, zilitë, karrierizmat dhe hipokrizitë e




këtij cirku të larmishëm. Një komedi e ëmbël dhe e hidhur njëkohësisht, që zbulon intrigat e prapaskenës të një prej misioneve "humanitare", nga ku lind natyrshëm pyetja: si mund t'u vijë në ndihmë Perëndimi vendeve në zhvillim, kur ka qasje megallomane dhe dominuese, dhe si mundet që një vend në tranzicion të pranojë ndihmën e atyre që tallen me identitetin e tij. Ironia e mprehtë dhe therëse e Aliçkës - që si ish-diplomat e njeh mirë botën që rrëfen - godet si shpëtimtarët e zellshëm ndërkombëtarë, ashtu edhe vendasit e nënshtruar dhe fatkeqë. Një roman sarkazmë, i freskët dhe gazmor, që meriton të zërë vend nderi në traditën më të mirë ballkanike të këtij zhanri. Romani "Rrëfenjë me ndërkombëtarë" i shkrimtarit Ylljet Aliçka është botuar në shqip nga Botimet Toena në vitin 2009. Ndërkohë, ai është përkthyer dhe botuar edhe në Francë dhe në Norvegji dhe është në proces botimi në Egjipt.

# KUMBARO HEDH FIRMËN E FUNDIT SI MINISTRE E KULTURËS, NJË FJALË PËR RAMËN E LIBRIN

**Ministrja e Kulturës ende në detyrë Mirela Kumbaro, ka treguar vendimin e fundit që ajo ka marrë në këtë post, pasi dje do të miratohej dekreti për shkarkimin e saj nga Kuvendi.**

**Në një postim në 'Facebook', Kumbaro shkruan se është krenare për këtë vendim, pasi do të krijohet Qendra Kombëtar e Leximit të Librit.**

**"Faleminderit Skuadrës së Kulturës që e krijoi dhe qeverisë dhe Kryeministrit Rama, që e miratoi sot. Faleminderit të gjithë miqve që mbështesin Lëvizjen Kombëtare për Lexim", shton ndër të tjera Kumbaro.**



Opinioni *i* Ditës

# Masakra e gjasave për integrim

Nga Fatos Çoçoli

*(vijon nga faqja 1)*



... një ministri të Jashtëm të mirëfilltë për të filluar turet, bisedimet, takimet dhe dhënien e bollshme e bindëse të informacionit për detyrat e shtëpisë të realizuara në këtë gjysmë periudhe prove(viti i plotë është qershor 2018-maj 2019) do të jetë e lartë. Kur do të kujtohemi: dy muaj përpara se sa të vijë afati i vendimit, qershori 2019? Me stinën dimërore të protestave, me kauzën studentore (e cila, për fat është mbajtur ende larg kthetrave të politikës), si dhe me opozitën që betejën e vetme që sheh përpara e ka protestën dhe rritjen e tensionit politik, vendi ynë do të duket nga Brukseli krejtësisht i papërgatitur për të hapur bisedimet për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Një shtyrje e re e afatit të çeljes së bisedimeve do të ishte krejtësisht e padrejtë për qytetarët e këtij vendi. Sepse ajo përkthehet në dhjetëra miliona euro projekte të panisura me BE-në, të humbura nga mungesa e klimës së duhur të besimit dhe bashkëpunimit që prodhon hapja e bisedimeve. Përkthehet në vijimin e stepjes së investuesve të rëndësishëm dhe strategjikë që e presin këtë çelje negociatash si shenjë për të hyrë bindshëm me projekte të rëndësishme tek ne. Menjëherë pas anëtarësimit në NATO, nisën bisedimet për investimet për hidrocentrale në lumin Devoll dhe u miratua gazsjellësi TAP, projekte që i sollën deri tani Shqipërisë 1.6 miliardë euro. Shpresonim që edhe hapja e bisedimeve për anëtarësim me BE-në të ishte një levë e tillë arkimedi, si anëtarësimi në NATO, për investime të huaja po aq serioze, afatgjata dhe me kapital konkret (jo me partneritete publik-privat në erë që dorën e kanë tek xhepi i Buxhetit të Shtetit shtrirë ndër vite). Investimet serioze janë gati të vijnë, jo vetëm nga vendet e Bashkimit Evropian, por edhe nga përtej oqeanit. Struktura shumë të fuqishme bankare dhe financiare, të interesuara për vendin tonë si qendër investimesh në Ballkanin Jugperëndimor, janë gati të hyjnë, në rast të përgjegjshmërisë së ngritur shtetërore që do të sjellë hapja e negociatave. Mirëpo kjo shpresë, me këtë fillim katastrofik viti po rrezikohet seriozisht. Duket paradoksale, por tensioni politik në rritje dhe klima e protestave ditore mund të arrijnë edhe të mpakin tek perëndimorët efektin e reformës në drejtësi, e cila tek ne po vazhdon dhe ka patur përparime të dukshme në periudhën qershor-dhjetor 2018. Kryerja e kësaj reforme ka qenë kushti kryesor i Brukselit për çeljen e bisedimeve, por tani katrahura me gjendjen kemi ministër apo jo ministër të jashtëm dhe aradha e protestave po e zbeh këtë kusht që po plotësohet! Kjo do të ishte gati fatale për fatet e rrugëtimit tonë në familjen e madhe evropiane. Asnjë thirrje deri tani nga shoqëria jonë civile, që të ndalet masakra e gjasave për integrim. Asnjë dalje nëpër rrugë për të mos ia prishur këtë shans unikal Shqipërisë, në emër të politikës së ditës. E dimë papërgjegjshmërinë e skajshme të politikanëve tanë, por ende edhe mediat nuk u ka rënë tambureve të integrimit që po rrezikon të ngelet në cektinë. Në lojë janë shumë më tepër interesa jetësore për qytetarët e këtij vendi, në krahasim me interesat e ndërrimit të pushtetit tek ne. A e kemi fuqinë të ndalim apo fshikullojmë paturpësinë e politikës në këto momente? Do të duhej një lëvizje qytetare me tiparet e lëvizjes së mrekullueshme studentore të 4-26 dhjetorit 2018, për ta shkundur fort këtë politikë mjerane të ditës dhe për të prishur planet e saj ogurzeza të humbjes së drejtpeshimit të vendit, me shpresë paralizimin e reformës në drejtësi dhe gjuajtjen e ndonjë shansi për pushtet. Do të duhej rikthimi i frymës në Shqipëri të protestave kundër armëve kimike nga Siria të 5 viteve më parë. Por a do të jemi në gjendje si qytetarë, apo ato pak struktura të shoqërisë civile, ende të përgjegjshme, që të ngremë zërin si dha sa duhet, për të ftuar qytetarët në rrugë, në mbrojtje të integrimit të vendit? Rrjetet sociale janë aty si armë të jashtëzakonshme për të mobilizuar njerëzit, sidomos të rinjtë. Sikur protesta studentore, krahas kauzës së përmirësimit thelbësor të arsimit të lartë publik, të rrokte edhe mbrojtjen e gjasave të integrimit, që realisht po masakrohen.



Dje në "Deutsche Welle"

# Kundër BE-së, pro kombit - Populizmi në rritje

Nga Christoph Hasselbach




*(VIJON NGA FAQJA 1)*

**GJERMANI - ALTERNATIVA PËR GJERMANINË, AFD**

... kërkon në programin e saj pasoja të forta. "Atëherë ne e konsiderojmë si opsion të fundit daljen e Gjermanisë apo një shpërbërje të rregulluar të Bashkimit Europian dhe themelimin e një bashkësie të re europiane interesash ekonomike." Si euron edhe Parlamentin Europian kjo parti e quan të tepërt. Gjermania duhet të kthehet te marka gjermane. Grindje ka vetëm për atë se sa shpejt duhet të reformohet BE. Kërkesa për afat 5-vjeçar u zbut së fundmi në programin e partisë për zgjedhjet europiane në një formulim të vagullt "në kohë të përshtatshme".

**BRITANI E MADHE - UKIP**

Partia për Pavarësinë e Britanisë së Madhe e sheh misionin e saj më të rëndësishëm gati të përmbushur: daljen e Britanisë së Madhe nga BE. Kjo është arsyeja, pse UKIP që nga referendumi është dobësuar në elektorat. Pse duhet votuar UKIP, kur edhe partitë e mëdha, konservatorët dhe laburistët po ashtu e duan daljen nga BE? UKIP trembet, se Brexit ose do të bëhet shumë i "butë" ose në fund shfuqizohet. Në këtë rast kjo parti sërish do të merrte hov. UKIP ka status heroi për të gjitha partitë në BE që duan të dalin nga Bashkimi Europian.

**FRANCA - LËVIZJA BASHKUESE KOMBËTARE - DIKUR FRONT NATIONAL**

Proeuropiani Emannuel Macron e rrëzoi rivalen e tij kritike ndaj BE, Marine Le Pen në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale. Por që nga protestat e "jelekëve të verdhë", Marine Le Pen ndjen se drejtimi i erës ka ndryshuar. Ajo ka mësuar nga humbja kundrejt Macronit. Kërkesa e atëhershme për daljen nga euro i kushtoi atëherë me sa duket shumë vota. Ajo e ka zbutur tani pozicionin e saj, në vend të kësaj duhet krijuar "Europa e kombeve", e rëndësishme është tani ruajtja e kufijve shtetërorë për të penguar migracionin ilegal. Marrëveshjen e Shengenit në formën aktuale ajo e refuzon.

**AUSTRIA - FPÖ**

Partia e Lirisë e Austrisë ka qenë deri në vitet 70-të një forcë pozitive për futjen e Austrisë në organizatat pararendëse të BE. Por që kur drejtimin e mori në dorë Jörg Haider në vitet 80-të, kjo parti është kthyer në një parti skeptike deri armiqësore ndaj BE. Tani në shenjë kujdesi ndaj partnerit më të madh të koalicionit qeverisës aktual nën Sebastian Kurz, kjo parti paraqitet më e moderuar. Në fushatë, Kurz e vuri si kusht bashkëpunimi, që kjo parti të heq dorë nga të gjitha fjalimet që kërkojnë daljen e Austrisë nga BE. Që atëherë FPÖ kërkon më shumë reforma dhe më shumë të drejta për kombet në BE. Këtë e kërkon edhe konservatori Sebastian Kurz, por në një formë të zbutur.

**HOLANDA - PVV PARTIA PËR LIRINË**

Emigracioni dhe islami janë dy temat kryesore të kësaj partie. Në lidhje me Europën kjo parti nuk paraqitet me shumë nerv, pozicionet e saj afrohen me ato të partive të tjera antieuropiane. Ndikimi i BE duhet të zvogëlohet, shtetet të forcohen. Ashtu si AfD, edhe PVV holandeze kërkon heqjen e Parlamentit Europian dhe Komisionit Europian. Bashkëpunimi europian duhet të zhvillohet nga vetë shtetet kombëtare. Nuk kërkohet shprehimisht dalja nga euro, por PVV kërkon referendum për të vendosur, nëse Holanda do të qëndrojë apo do të dalë nga BE.

**POLONIA - PIS**

Ka një dallim të madh mes partive populiste të djathta të Europës perëndimore dhe Partisë Për Ligj dhe Drejtësi, PiS. Kjo parti nuk është parti opozitare apo partnere e vogël e koalicionit, por parti qeverisëse. Ndaj BE kjo parti ka një qëndrim të dyzuar. BE është për PiS shumë liberale-laike, shumë pro globalizmit dhe refugjatëve. Nga ana tjetër tek PiS e dinë, se rritja e mirëqenies së Polonisë, varet shumë nga qenia pjesë e BE dhe pagesat që vijnë nga Brukseli. Tjetra - Polonia ka nevojë për BE si partnere për të mbajtur larg Rusinë. Kështu PiS nuk flet për daljen nga unioni. Madje Varshava e mbështet thellimin e bashkëpunimit brenda BE në fushën e mbrojtjes. Por kjo parti nuk i do ndërhyrjet nga BE - si në çështjen e shpërndarjes së refugjatëve, ashtu edhe në dobësimin e shtetit ligjor.

**HUNGARIA - FIDESZ**

Hungaria ka shumë ngjashmëri me Poloninë. Fidesz qeveris e vetme, si PiS në Poloni. Ajo po ashtu e refuzon shpërndarjen e refugjatëve. Kryeministri, Viktor Orban përpiqet të fusë nën kontroll shtetin ligjor, po ashtu si PiS. Ai bën kompromis deri ku i duhet për kërkesat që vijnë nga Brukseli, me qëllim që injeksionet financiare nga BE të vazhdojnë të rrjedhin. Sepse edhe ai e di nga logjika ekonomike, se vendi i tij duhet të mbetet në BE. Një dallim i madh megjithatë ekziston: Në një kohë që partia qeverisëse polake, PiS sheh tek BE dhe NATO një garanci kundrejt Rusisë dhe kërkon sanksione më të ashpra, Orban është një admirues i presidentit rus, Vladimir Putin dhe ka kontakte të ngushta me të.

**ITALIA - LEGA**

Lega është një rast i veçantë. Ajo quhej në fillim Lega Nord-një parti rajonale e veriut të pasur italian. Për një kohë të gjatë ajo kërkonte shkëputjen nga shteti i bashkuar italian. Në këtë kontekst, Lega e dikurshme ishte miqësore ndaj BE-së, sepse tek Bashkimi Europian shihte një kuadër për rajone të fuqishme europiane. Sot ajo quhet thjesht Lega, dhe e ka zgjeruar si parti influencën e saj në të gjithë Italinë, ajo tani është partnere e vogël e koalicionit populist në Romë. Kreu i saj, ministri i Punëve të Brendshme, Matteo Salvini, nuk lë t'i ikë asnjë mundësi aktualisht pa sulmuar Bashkimin Europian për gjoja përzierjet e tij, sidomos në politikën e brendshme.

Një kohë të caktuar Salvini kërkonte edhe heqjen e euros. Por për këtë tani atij nuk i dëgjohet më zëri. Për ironi të fatit, Salvini madje e ka promovuar veten edhe si president të mundshëm të Komisionit Europian, atëherë kur aleanca e partive populiste të djathta pas zgjedhjeve europiane të jetë fraksioni më i fuqishëm ose i dyti në renditje. "Miq në mjaft vende europiane ma kanë kërkuar këtë", ka thënë Salvini në një intervistë për media në nëntor. "Të shohim, do mendohem."

## HOROSKOPI

### DASHI

Të lindurve të kësaj shenje nuk do t'i pëlqejë atmosfera sot. Do të përballeni me vështirësi në profesionin tuaj. Mund t'ju humbasë durimi për shkak të telasheve. Nuk është dita e duhur për të bërë blerje, pasi mund të pësoni humbje.

### DEMI

Disa Demë nuk do të kënaqen nga bisedat miqësore ose zyrtare. Partneri juaj në biznes mund të dështojë sot. Do të ketë një mënyrë për të zgjidhur problemet e shkaktuara nga ky person. Në mbrëmje do të ndiheni shumë të lodhur fizikisht por psikologjikisht.

### BINJAKET

Binjakët mund të kalojnë një ditë shumë të mirë, por vetëm nëse nuk bëheni pesimist. Duhet të tregoni gjithë fuqinë tuaj, kur të nisni një projekt të ri por të vështirë. Dikush do t'ju kujtojë të kaluarën. Mos e lejoni atë t'ju shkatërrojë jetën.

### GAFORJA

Disa Gaforre mund të presin një surprizë të këndshme. Do të keni fat si në aspektin personal ashtu edhe në atë profesional. Një çështje financiare do t'ju zgjidhet me sukses. Gaforret e vetmuara të shohin me kujdes miqtë e rinj.

### LUANI

Përpiquni të mbani veten nën kontroll. Shumë gjëra do të varen nga mënyra sesa shpejt do të reagoni dhe sesa të aftë do të jeni për të vënë punët përpara. Dikush do t'ju çojë drejt rrugës së prosperitetit financiar.

### VIRGJERESHA

Personat e kësaj shenje duhet të përkushtohen për të konsoliduar suksesin e së kaluarës. Mos lejoni triumfin të mposhtet nga thashethemet apo xhelozia. Mos i harroni personat që shqetësohen vërtet për ju. Kaloni sa më shumë kohë nën shoqërinë e tyre.

### PESHORJA

Peshoret do të kenë një tjetër mendim rreth një personi apo eventi. Paraditja do të jetë shumë e ngjeshur për ju, ndërsa pasditja do të jetë e qetë dhe monotone. Marrëdhëniet tuaja personale do të jenë në rrugën e duhur.

### AKREPI

Dita e sotme do të kalojë sikur të ishte një moment i vetëm. Përpiquni ta kaloni ditën në paqe dhe në qetësi. Mos ia shfaqni botën tuaj të brendshme njerëzve rreth jush. Do të kaloni një mbrëmje shumë të këndshme nën praninë e partnerit/partneres suaj.

### SHIGJETARI

Disa Shigjetarë do të çlirohen nga ankthet afatgjata. Në marrëdhënien tuaj romantike mungon energjia. Në jetën profesionale, përpiquni që disa detyra t'ia kaloni dikujt tjetër, pasi jeni tejet të ngarkuar. Mos u shqetësoni nëse rezultatet e ditës së sotme nuk janë ato që prisnit.

### BRICJAPI

Mos u bëni dinak, përfshihuni në argument ose në një bisedë të rëndësishme. Çdo mashtrim apo përpjekje për të fshehur të vërtetën do të refuzohet. Ka gjasa që të ndiheni shumë në siklet në marrëdhënien tuaj romantike.

### UJORI

Kjo ditë do të jetë plot fat në marrëdhëniet tuaja personale. Beqarët e kësaj shenje ka gjasa të takojnë aksidentalisht dike me të cilin mund të nisin një marrëdhënie romantike. Bëni kujdes në punë pasi mund të debatoni ashpër me një nga kolegët tuaj.

### PESHQIT

Peshqit mund ta kalojnë këtë ditë duke u kujdesur për të afërmit e tyre. Nëse përfshiheni në marrëdhënien e dikujt, mund të harroni veten dhe gjithçka që kishit në plan. Mos harroni punën dhe marrëdhëniet potenciale.

## Goli i portugezit thyen Milanin në Jedah

# Ronaldo një përbindësh, Juve fiton superkupën

Juventusi doli fitimtar në finalen e Superkupës së Italisë, zhvilluar pasditen e djeshme në Jedah të Arabisë Saudite. Sfida përfundoi në shifrat 1-0, me golin e vetëm shënuar me kokë nga Kristiano Ronaldo, në minutën e 61-të të takimit. Pjesa e parë, ishte e qetë, me pak raste për të dyja formacionet. Më pas, e dyta nisi menjëherë me një traversë të Kutrones, i cili nuk zhbllokoi shifrat vetëm për pak centimetra. Gjithçka u zhbllokua në minutën e 61-të, me Ronaldon që iu vodh mbrojtjes kuqezi, e cila e harroi, dhe shënoi me kokë përballë Donarumës. Gatuzo u përpoq të reagonte me Higuainin dhe Borinin, por vetëm pak çaste më pas, ishte mesfushori Kesi, që pas verifikimit në VAR, u ndëshkua me karton të kuq për një shkelje me takë ndaj Çan. Kështu, ekipi i Alegrit fiton trofeun e parë sezonal, dhe konfirmon formën fantastike këtë sezon, e shkon bindshëm për të fituar Serinë A, dhe tregon forcën edhe për Ligën e Kampionëve. Menjëherë pas fitimit të Superkupës kundër Milanit, ka folur autori i golit vendimtar, Kristiano Ronaldo. Për "Rai Sport" portugezi u shpreh: "Ishte ndeshje shumë e vështirë dhe e nxehtë. Bëmë një takim të madh, duke krijuar shumë raste dhe jam i lumtur që ia arritëm të fitonim. Trofeu i parë me Juventusin ishte ajo që doja për ta nisur mirë 2019-tën. Do të vazhdojmë të punojmë me qetësi për të fituar edhe në të ardhmen. Është ende rrugë e gjatë. Këtë fitore ia dedikoj tifozëve, familjes dhe shokëve të mi", përfundoi Ronaldo. Ai ishte autori i golit të vetëm të takimit, duke koleksionuar edhe trofeun e parë si bardhezi.

"Raketa" e krahut të djathtë ka nisur grumbullimin me Akhmatin dhe shpreson të jetë gati



Jeton Selimi

# Roshi: Kombëtarja nuk shkëlqeu, por do ta nisim si me Portugalinë

## *Mesfushori pret një sezon kuqezi fantastik*



Odise Roshi ka qenë një nga mungesat e mëdha të përfaqësueses shqiptare gjatë Ligës së Kombeve për shkak të dëmtimi të pësuar që e la jashtë fushave të lojës për një kohë të gjatë. Mesfushori tregon se tani është më pranë kthimit në fushën e lojës, edhe pse i duhet edhe një muaj për të qenë në maksimum e për të zbritur rregullisht edhe ai në terrenin e gjelbër. "Prej dy ditësh jam i grumbulluar me skuadrën e Akhmat Grozni. Kemi një fazë të gjatë përpara. Në fund të shkurtit nis kampionati. E nisim pak me vonesë, pasi, siç dihet, temperaturat janë nën minus. Për momentin jam shumë mirë. Dje kam bërë disa teste, të cilat dolën pozitive. Por më duhet edhe pak kohë, besoj 1 muaj që të jem 100%, që të stërvitem me ekipin. Do filloj gradualisht që të futem pak nga pak. Po stërvitem në mënyrë individuale. Po stërvitem edhe me grupin, ato 10-20 minutat e para të stërvitjes, pastaj kaloj individual me trajnerin personal që kam këtu", shpjegoi ai në një intervistë për "Ora News". "Kam folur me trajnerin dhe doktorin, ku më kanë thënë se do të jem gati 100% për rifillimin e kampionatit. Nganjëherë nuk i dihet. Varet nga trupi i njeriut. Kur e ndjen futbollisti veten mirë atëherë mund të zbres në fushë. Besoj se para datës 5 do të jem i gatshëm dhe për këtë fakt duhet të jem edhe i gatshëm për ekipin kombëtar",-vijoi ai. Por si e ka parë Roshi kombëtaren si tifoz në këtë periudhë mungese? Fillimisht mesfushori tregon se nuk ka pasur gjatë këtyre muajve kontakte me Panuçin, ndërsa më pas pohon se skuadra ka shfaqur disa mangësi.
"Gjatë kësaj kohe nuk kam pasur kontakte të drejtpërdrejta me Panuçin, por kam pasur me ndihmësit e tij, trajnerin e dytë, me të kam pasur gjithë kohës. Besoj se nuk ka qenë një kombëtare shumë e mirë, por kemi bërë edhe paraqitje të mira. Kemi bërë edhe paraqitje të këqija si gjithmonë. Por besoj se ka pasur edhe shumë mungesa të disa lojtarëve, që po të ishin, do të kishin arritur edhe rezultate më të mira. Shpresojmë që në ndeshjen e parë eliminatore të marrim 3 pikët, dhe pastaj të ecim siç bëmë përballë Portugalisë në Evropian. Morëm 3 pikët e para edhe kaluam. Shpresojmë te e njëjta gjë edhe këtë vit", theksoi ai.
Roshi është në vitin e fundit të kontratës me Akhmat Grozni, por pranon se për momentin nuk është i fokusuar te kjo çështje, por te riaftësimi dhe aktivizimi sa më i rregullt. "Me thënë të drejtën këtë nuk e di akoma se jam marr vetëm me planin përkatës dhe nuk kam komunikuar as me klubin për kontratën apo diçka tjetër. Thjesht dua të kthehem në 100% të formës",-deklaroi ai.

## TRAJNERI I TIRANËS

# Mema: Kemi ende probleme, pres përforcime

Fitorja me përmbysje në miqësoren ndaj Besës, e sidomos reagimi dhe paraqitja e lojtarëve të rinj në testin e sotëm ndaj Besës së Kategorisë së Parë, e kanë bërë optimist edhe trajnerin e skuadrës së Tiranës, Ardian Mema. Ky i fundit ka besim se Tirana e tij do të jetë edhe më solide në pjesën e dytë të sezonit, gjithmonë, nëse ruan grupin dhe kualitete, por edhe nëse bën ndonjë afrim që do të ishte më të vërtetë efikas për atë dhe skuadrën. Në një prononcim që ka dhënë për "Supersport", trajneri i 24 herë kampionëve, Ardian Mema ka pohuar: "Duhet të jemi të sinqertë, kemi ende probleme. Nuk më pëlqeu skuadra në pjesën e parë, ishim të ngadaltë ndoshta edhe për shkak të ngarkesës së fazës përgatitore. Në pjesën e dytë, me zëvendësimet e bëra, ishim më mirë dhe arritëm të përmbysnim rezultatin. Shpresojmë të afrojmë lojtarë, por nuk mund të jap emra konkretë".

## PORTIERI I KUKËSIT

# Frashëri: Titullin e ndajmë me Partizanin, Skënderbeun e Teutën



Portieri i Kukësit, Stivi Frashëri, sheh një luftë më të ndezur në pjesën e dytë të kampionatit pasi beson se skuadrat do të jenë më të përgatitura për t'u përballur me ndjera-tjetrën, sidomos ata që rivalizojnë për titull. Ai shpreson që faza përgatitore që ekipi ka zhvilluar në Antalia, ku është ndeshur me ekipe mjaft cilësore dhe ka provuar forcën me to, të ndihmojë edhe me shumë verilindorët për të qenë gati për rifillimin. "Ishin ndeshje që na ndihmonin ne për ecurinë tonë, për të ngritur nivelin dhe atë që kërkojmë. Arritëm të përfitonim nga këto ndeshje atë që kërkonim. Besoj që kemi rivalë të denjë për titull si Partizani, Teuta e Skënderbeu që nuk ngelet mbrapa. Shpresoj që të marrim pikët maksimale kundrejt këtyre rivalëve",-tha ai për RTSH.

"Për mendimin tim besoj që dy fazat e dyta do të jenë më të vështira se dy fazat e para se ekipet studiojnë njëra-tjetrën. Unë akoma nuk e kam provuar shijen e të qenit kampion, por të dilja kampion me Kukësin do të ishte e mrekullueshme",-vijoi portieri. Ndërkohë, ai mendon se te Kukësi po kalon ndoshta formën më të mirë të karrierës edhe për faktin se ka gjetur mbështetje në këtë klub dhe po luan me rregullsi. "Që në momentin kur kam ardhur te Kukësi kam pasur momente shumë të mira, që në kohën kur fitova postin e titullarit jam ndjerë mirë e i vlerësuar. Shpresoj të vazhdoj të jap maksimumin, nuk e kam mendjen te ndonjë rekord personal, edhe nëse ndodh do të jetë e veçantë. Kjo tregon që ekipi ka një ecuri shumë të mirë, si mbrojtja edhe porta jep siguri për ekipin dhe kjo na bën të ndjehemi mirë",-deklaroi Frashëri.

## ISH-KAPITENI

# Ksavi: Kimish është ideal për Barcelonën



Ksavi Hernandez ka evi dentuar një futbollist që mund t'i bëjë punë Barcelonës. Ai është Joshua Kimish, mesfushori i Bajernit të Mynihut. 23-vjeçari është provuar në shumë role te gjermanët dhe do të ishte një opsion i mirë si mbrojtës i djathtë te Barcelona, por edhe si mesfushor. "Fola me Guordiolën për të. Kimish është e ardhmja dhe e tashmja e Bajernit dhe kombëtares gjermane. Mund të luajë në çdo pozicion. Është lojtari perfekt për Barcelonën. Në karrierën time gjithmonë kam mbajtur një sy hapur për lojtarë që mund t'i përshtaten Barcelonës",-përfundoi për "Bild" Ksavi.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al